



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 30 regjistër (JR)
Datë 06.06.2019

Nr. 22 i vendimit
Datë 16.09.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 16.09.2020, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 136, datë 09.04.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 63 e vijues i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 136, datë 09.04.2019, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fehmi Petku, gjyqtar e drejtues në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.*
2. Komisioni administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), në bazë të neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), në bazë të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”), në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.
3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë, arriti në konkluzionet:
 - i. Për pasurinë truall me sipërfaqe 372 m² dhe banesë mbi këtë truall, e përbërë nga tri kate, bodrum dhe papafingo, ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, që përfshihet në analizën financiare për periudhën 1994-1996: i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive, në kundërshtim me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. ii) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e përdorur për krijimin e pasurive. iii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës. iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.*
 - ii. Për pasurinë shtëpi banimi, e përbërë nga dy kate banimi dhe bodrum, me sipërfaqe kati 130 m², e ndodhur në {***}, Tiranë: i) *Trupi gjykues çmon se mospërputhjet e deklaratës noteriale të depozituar me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë fakte që vijnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. ii) Shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës. iii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.*
 - iii. Për pasurinë ndërtim informal mbi truallin me sipërfaqe 16000 m², të ndodhur në {***}, Tiranë: i) *Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje në deklaratën “vetting” dhe në deklaratën e interesave private të vitit 2015, të këtij ndërtimi. ii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës. iii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.*
 - iv. Për pronësinë mbi aksionet e shoqërisë “{***}” ShPK: i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të bindshme burimin e krijimit të ligjshëm të këtyre vlerave monetare, sipas paragrafit 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. ii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61*

të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- v. Për analizën e treguesve financiarë, pasuri, detyrime, të ardhura, shpenzime të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016: i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të bindshme burimin e ligjshëm të të ardhurave për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe shpenzimet e deklaruara dhe të llogaritura sa më sipër, sipas nenit D të paragrafit 3 të Aneksit të Kushtetutës. ii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
4. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kontrollin e figurës, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar, për shkak të mundësisë për vënien e tij nën presion nga strukturat kriminale, për favorizim apo për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, në papajtueshmëri të plotë me detyrën.
5. Në vlerësim tërësor të të tria kriterëve, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit profesional, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar rëndë besimin e publikut të drejtësia, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit

6. Kundër vendimit nr. 136, datë 09.04.2019, të Komisionit është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) nga subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku, i cili kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmim në detyrë.
7. Shkaqet e ankimit lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale, procesit të rregullt ligjor, si dhe me vlerësimin që ka kryer Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
8. Shkaqet e ankimit që lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale dhe procesit të rregullt ligjor në mënyrë të përmbledhur, janë si vijojnë.
 - a) Kolegji i Posaçëm i Apelimit është gjykata e vetme që shqyrton ankimin, në mbështetje të nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykimi i këtij ankimi të bëhet në seancë dëgjimore publike, në prani të palëve, përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë pikërisht për shkak të parashikimit të tyre në nenin 17 të Kushtetutës.
 - b) Varësia administrative e këshilltarëve ekonomikë dhe ligjorë pranë Komisionit paragjykon paanshmërinë dhe rezultatet e gjetura prej tyre, si të njëanshme.
 - c) Komisioni nuk lejoi në asnjë rast paraqitjen e një raporti alternativ nga ekspertë të tjerë, pavarësisht se pati kërkesë nga subjekti, duke shkaktuar në këtë mënyrë shkelje flagrante të procesit të rregullt ligjor.

- ç) Mospranimi i kërkesave të paraqitura për kryerjen e një ekspertize me ekspertë të pavarur për vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe financiare, e bën të cenueshëm procesin, pasi është shkelur parimi i barazisë së armëve.
- d) Mosmarrja në konsideratë e provave të paraqitura nga subjekti, sa i takon pasurisë së paluajtshme, si dhe treguesve financiarë të të ardhurave dhe shpenzimeve për jetesë, duke bazuar vendimmarrjen në të dhëna të mbledhura në mënyrë të njëanshme, nga ana e Komisionit.
- dh) Përmendja e të dhënave personale (emër, mbiemër) të personit të lidhur, djalit, në tekstin e vendimit nr. 136, datë 09.04.2019, të Komisionit, përbën cenim të të dhënave personale dhe shkelje flagrante të jetës private dhe familjare, që mbrohet nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- e) Arsyetimi i vendimit të Komisionit është në tejkallim të qëllimit të hetimit dhe në kundërshtim të plotë me përcaktimet e nenit 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016. Objekt i shqyrtimit të Komisionit është deklarata e pasurisë *vetting*, e plotësuar nga subjekti sipas kërkesave të ligjit dhe vlerësimi sa u përket pasurive të deklaruara, burimeve të ligjshme për krijimin e tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare dhe nxjerrjes së konkluzionit përfundimtar mbi raportin pasuri të ardhura, i cili sipas ligjit nuk duhet të kalojë raportin e dyfishit të pasurisë së ligjshme.
9. Shkaqet e ankimit që lidhen me themelin e gjykimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijojnë.
- a) Për pasurinë banesë, e përbërë nga tri kate, bodrum, papafingo, e ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kontributin e dhënë nga të gjithë familjarët, ndihmën e shoqërisë “{***}”, si dhe ka bërë përllogaritje të gabuara dhe të pasakta të kostos së ndërtimit të kësaj banese.
- b) Lidhur me pasurinë shtëpi banimi, e përbërë nga dy kate banimi dhe bodrum, me sipërfaqe kati 130 m², e ndodhur në {***}, Tiranë, Komisioni në mënyrë të padrejtë përllogarit përfundimin e ndërtimit të kësaj banese në dhjetor 1996, duke mos marrë në konsideratë një sërë argumentash dhe provash të paraqitura nga subjekti, si dhe mohon padrejtësisht disa burime financiare të familjes që kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj banese.
- c) Sa i përket pasurisë ndërtim informal mbi truallin me sipërfaqe 16000 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, subjekti nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë të drejtë pronësie mbi atë objekt dhe për këtë shkak nuk e ka pasqyruar si pasuri, pasi me deklaratën noteriale nr. {***} rep., datë 19.06.2016, është hequr dorë nga çdo e drejtë pronësie mbi këtë objekt, duke lejuar ALUIZNI-n që procedurat ligjore për legalizimin e këtij objekti të vazhdonin në emrin e vëllait të subjektit.
- ç) Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, subjekti pretendon të mos jenë marrë parasysh provat e paraqitura mbi burimet financiare që nuk analizohen as në vendimin përfundimtar. Të kombinuara dhe të mbivendosura, efektet e këtyre zërave së bashku, ndikojnë në paraqitje të situatës joreale të të ardhurave dhe shpenzimeve, si për periudha të veçanta ndër vite, ashtu edhe në përllogaritjen e rezultatit të përgjithshëm të periudhës së vlerësimit 2003-2016.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

10. Çështja e rivlerësimit me nr. 30 regjistër (JR), datë 06.06.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Fehmi Petku, i cili ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 136, datë 09.04.2019, u mor në shqyrtim në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).
11. Subjekti i rivlerësimit, pas marrjes së njoftimit për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, më datë 16.09.2020, ka paraqitur në Kolegj parashtrimet me shkrim 5 ditë para seancës gjyqësore¹. Subjekti ka paraqitur parashtrime lidhur me shkaqet e ankimit që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, sa i përket banesës në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë dhe banesës së ndodhur në fshatin {***}. Sipas subjektit, në tabelën e përllogaritjeve të pasurive të paluajshme, si dhe lidhur me burimet financiare që kanë shërbyer për vënien e këtyre pasurive nga trashëgimlënësi, Komisioni ka vepruar gabim duke bërë nga njëra anë një vlerësim jo real të vlerave të tyre në raport me faktet e paraqitura nga subjekti dhe, nga ana tjetër, nuk ka bërë në mënyrë të plotë dhe të drejtë pasqyrimin e burimeve financiare të vërtetuara me dokumente shkresore, të paraqitura para tij. Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit për pasurinë banesë, e ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, dhe për banesën e ndodhur në fshatin {***}, Tiranë, janë të trajtuara dhe në shkaqet e ankimit të tij.
12. Subjekti, së bashku me parashtrimet me shkrim, kërkoi dhe marrjen në cilësinë e provave të reja të akteve të mëposhtme.
 - i. Vërtetim nr. {***}prot., datë 22.01.2019, i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme, Divizioni i Operacioneve, Raiffeisen Bank, me anë të të cilit vërtetohet se babai i subjektit, z. A. S. P, ka tërhequr pranë Bankës së Kursimeve, në periudhën 1995 - 1997, shumën prej 200.000 lekësh në dorë dhe 258.685 lekë privatizimi. Këto shuma i ka përfituar nga statusi si ish-i përndjekur politik.
 - ii. Material me pamje filmike të banesave në {***}.
 - iii. Fotografi të nxjerra nga pamjet filmike (4 copë).
 - iv. Tabela e Entit Kombëtar të Banesave me kostot mesatare të ndërtimit për vitet 1995-2016, në dy zëra: sipërfaqe shfrytëzimi dhe sipërfaqe ndërtimi.
 - v. Procesverbal i organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për njohjen me aktin e ekspertimit (datë 08.06.2020).
13. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos pranojë këto prova të paraqitura me parashtrimet, pasi vlerësoi se bazuar në nenet 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në këtë fazë të procesit palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe jo fakte apo prova të reja, si dhe subjekti nuk provoi pamundësinë e paraqitjes së këtyre provave gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Trupi gjykues vlerësoi se, edhe nëse këto prova do të merreshin në konsideratë prej tij, ky fakt nuk do të ndryshonte vendimin përfundimtar.

¹ Parashtrimet janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit më datë 10.09.2020 dhe janë protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 11.09.2020.

III/1 Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se, *duke qenë se Kolegji i Posaçëm i Apelimit është gjykata e vetme që shqyrton ankimin, dhe në këtë mosmarrëveshje nuk ka elemente të një karakteri të theksuar teknik, por ka një ndërthurje mes elementeve juridike të së drejtës, faktike, dhe çështje të vlerësimeve ekonomiko-financiare, në mbështetje të nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykimi i këtij ankimi të bëhet në seancë dëgjimore publike, në prani të palëve, përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Për këtë pretendim, subjekti referon në disa çështje të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: Fredin kundër Suedisë (nr. 2) paragrafi 21-22; Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), paragrafi 46; Göç kundër Turqisë, paragrafi 47; Koottummel kundër Austrisë, paragrafi 19; Miller kundër Suedisë, paragrafi 29; Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, paragrafi 37.*
Trupi gjykues i Kolegjit, sa i përket këtij pretendimi, vëren se rastet e përmendura nga subjekti në ankimin e tij, si çështje ligjore pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, referojnë në të drejtën e një seance dëgjimore publike, e sanksionuar në nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, para *instancës së parë dhe të vetme të gjyqësorit*. Gjykata thekson se në procedurat para gjykatës së shkallës së parë dhe instancës së vetme, e drejta për një “dëgjese publike”, sipas nenit 6, paragrafi 1 i Konventës, nënkupton të drejtën për një “seancë dëgjimore”, përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme, të cilat justifikojnë përjashtimin e një seance të tillë. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues arsyeton se në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kolegji i Posaçëm i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në kuptim të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor i Kolegjit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48 pika 1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, të cilat harmonizojnë procedurën e ndjekur nga Kolegji, gjatë shqyrtimit të çështjeve, me atë të Gjykatës Administrative të Apelit.
15. Nga analizimi i akteve shkresore të dosjes gjyqësore, trupi gjykues çmon se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në zbatim të pikës 2 të nenit 179/b të Kushtetutës, ka kryer procesin e rivlerësimit të subjektit, bazuar në parimin e një procesi të rregullt ligjor. Me vendimin nr. 6, datë 27.03.2019, trupi gjykues i Komisionit ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u zhvillua më datë 02.04.2019, në prani të trupit gjykues dhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se e drejta për të pasur një seancë dëgjimore publike është ezauruar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit të kryer në Komision. Trupi gjykues i Kolegjit vendos për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rastet kur vlerëson se plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës apo nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
16. *Për të argumentuar konceptin e procesit të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit në ankim i referohet parimit të barazisë së armëve, si element i qenësishëm i këtij procesi, i lidhur veçanërisht ngushtë me parimin e kontradiktorialitetit (Regner kundër Çekisë, paragrafi 146). Sipas subjektit, ky parim zbatohet edhe në rastin e çështjes kur është në shqyrtim çështja e shkarkimit të një gjyqtari (Baka kundër Hungarisë). Subjekti pretendon se barazia e armëve vendos detyrimin që çdo pale, në një procedurë gjyqësore ose administrative, duhet t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj, përfshirë edhe paraqitjen e provave – nën kushte të cilat nuk e vendosin atë në disavantazh ndaj palës tjetër (Regner kundër Çekisë [GC],*

paragrafi 146; *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës, paragrafi 33*). Sipas subjektit, rasti kur pala kundërshtare ka pozicione ose funksione që e vendosin atë në avantazh dhe e bën të vështirë për palën tjetër t'i kundërshtojë ato seriozisht, duke mos lejuar palën përkatëse të paraqesë dokumente relevante ose evidencë me dëshmitarë (*De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës, paragrafi 54 dhe 58*), ose, pala kundërshtare gëzon një avantazh të veçantë, për sa i përket aksesit në informacion apo gëzon një vend të veçantë për sa i përket vlerësimit gjyqësor (*Yvon kundër Francës, paragrafi 37*).

Trupi gjykues, në lidhje me këtë pretendim, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, konstaton se, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer hetimin administrativ paraprak, duke i garantuar subjektit ushtrimin e të drejtave themelore, mbi parimet e një procesi të rregullt ligjor.

Në përfundim të fazës së hetimit paraprak, subjektit i përcillen rezultatet e hetimit me gjetjet respektive për të tria kriteret e vlerësimit (pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional), njoftohet për kalimin e barrës së provës në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtën për njohjen me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit, pajisjen me kopje të tyre në përputhje me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të drejtën për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e provave mbështetëse. Në vijim të kërkesës së subjektit, Komisioni, me procesverbalin nr. {***} prot., datë 26.02.2019, ka dorëzuar dokumentacionin fizikisht të dosjes së hetimit (në sasi 1401 fletë), dosjes së ardhur nga ILDKPKI, si dhe materialin e hetimit administrativ të Komisionit, në format elektronik (CD). Në vijim të kërkesës së subjektit, Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 01.03.2019, ka vënë në dispozicion të subjektit dokumentacion shtesë. Nga komunikimet elektronike të vazhdueshme me Komisionin, si dhe në vijim të kërkesave të subjektit, me *e-mail*-in e datës 04.03.2019, i është vënë në dispozicion metodologjia dhe analiza financiare e kryer nga Komisioni.

Në mbështetje të fakteve më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjektit i është garantuar e drejta e njohjes me provat e administruara nga Komisioni, e drejta e paraqitjes së provave, koha e mjaftueshme për të përgatitur prapësimet dhe informacioni i plotë lidhur me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Gjatë zhvillimit të seancës publike në Komision, subjekti Fehmi Petku ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave në mbrojtje të pretendimeve të tij. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se procesi rivlerësimit në Komision, rezulton të jetë zhvilluar në përmbushje të garancive ligjore, për rrjedhojë pretendimi i subjektit për cenim të parimeve të procesit të rregullt gjyqësor, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit nuk është i bazuar.

17. *Sipas pretendimit të subjektit në ankim, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nuk është bërë me dije se cilët ishin këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë që kishin hartuar raportin e vlerësimit. Për më tepër, rezulton se këshilltarët ekonomikë dhe ligjorë janë të gjithë nën varësinë administrative dhe me marrëdhënie pune me Komisionin, për pasojë, ky fakt e paragjykon cilësinë e punës, paanshmërinë dhe rezultatet e gjetura prej tyre si të njëanshme, sepse e njëjta trupë që gjykon, është e njëjta që ka në marrëdhënie pune ata që paraqesin mendim të specializuar për Komisionin. Mungesa e neutralitetit të një eksperti, së bashku me rolin e tij në zhvillimin e procedurës, mund të zhvendosë balancën e procesimit në favor të një pale dhe në disfavor të palës tjetër, në shkelje të parimit të barazisë së armëve (*Sara Lind Eggertsdottir kundër Islandës, § 53; Letincic kundër Kroacisë, §51*). Eksperti mund të mbajë një pozitë dominuese në zhvillimin e procedurës dhe, për pasojë, të ushtrojë influencë të madhe në vlerësimin e gjykatës (*Yvon kundër Francës §37*).*

Trupi gjykues i Kolegjit, për këtë shkak ankimor, sqaron se në kuptim të nenit 22, pika 1 dhe nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë përbëjnë Njësia e Shërbimit Ligjor që funksionon pranë Komisionit dhe Kolegjit. Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet studimit të dosjes gjyqësore, përgatitjes së relacionit, i cili ka karakter kërkimor dhe analizues, si dhe asiston procesin e vendimmarrjes në institucionet e rivlerësimit. Këshilltari ligjor apo ekonomik nuk është një figurë procedurale e procesit të rivlerësimit, dhe mosnjohja e identitetit të tij nuk përbën shkak për cenimin e një procesi të rregullt ligjor. Referuar nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në kuptim të këtyre normave ligjore, Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron detyrat e parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, duke studiuar dosjen gjyqësore dhe hartuar relacionet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme për çështjen, në respektim të legjislacionit në fuqi. Relacionet e këshilltarëve të Njësia së Shërbimit Ligjor kanë natyrë këshilluese nga pikëpamja ligjore dhe ekonomiko-financiare, por nuk janë detyruese dhe, për më tepër, nuk kanë fuqi provuese siç ka akti i ekspertimit si provë në gjykim. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

18. *Në ankim, subjekti pretendon se Komisioni nuk lejoi në asnjë rast paraqitjen e një raporti alternativ nga ekspertë të tjerë, pavarësisht se pati kërkesë nga subjekti, duke shkaktuar në këtë mënyrë shkelje flagrante të procesit të rregullt ligjor. Mospranimi i kërkesave të paraqitura për kryerjen e një ekspertize me ekspertë të pavarur për vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe financiare, e bën të cenueshëm procesin, pasi është shkelur parimi i barazisë së armëve. Mosmarrja në konsideratë e provave të paraqitura nga subjekti për sa i takon pasurisë së paluajtshme, si dhe treguesve financiarë të të ardhurave dhe shpenzimeve për jetesë, duke bazuar vendimmarrjen në të dhëna të mbledhura në mënyrë të njëanshme nga ana e Komisionit. Gjykata, kur refuzon thirrjen e ekspertëve ose të dëshmitarëve të palëve, duhet të japë arsye të mjaftueshme për mosthirrjen e dëshmitarëve që të eliminojë arbitraritetin në gjykim. Gjykata kurrsesi nuk duhet të ndikojnë në kufizimin joproporcional të palës dhe aftësisë së saj për të paraqitur prova, dëshmitarë dhe argumentuar në mbështetje të qëndrimit të saj (Wierzbicki kundër Polonisë § 45).*

Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i vendimit nr. 5, datë 27.03.2019, të Komisionit, të marrë gjatë hetimit administrativ lidhur me kërkesën e subjektit mbi caktimin e një grupi ekspertësh vlerësues të pasurisë dhe ekspertëve financiarë për kryerjen e një ekspertimi në përbërje të të cilit të jenë dhe ekspertë të caktuar nga subjekti, vëren se ky vendim është bazuar në gërmat “a” dhe “c” të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016², dhe ka refuzuar këtë kërkesë, duke e konsideruar një veprim të tillë të panevojshëm dhe të papërshtatshëm, pasi ky organ ndihmohet nga një strukturë e posaçme, siç është Njësia e Shërbimit Ligjor, në përbërje të së cilës ka këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, të cilët studiojnë dosjen dhe përgatitin relacionet e çështjes veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit. Po kështu, Komisioni arsyeton se në përputhje me pikën 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, e bazon

² Neni 49, pika 6, gërmat “a” dhe “c” parashikojnë: “6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...] c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm”.

vendimmarjen mbi dokumente nga burime të njohura dhe në prova të besueshme. Vendimin e arsyetuar për refuzimin e kërkesës për kryerjen e ekspertimit, Komisioni ia ka njoftuar subjektit në respektim të procedurave ligjore. Në kryerjen e detyrave të tij, Komisioni apo Kolegji ndihmohet nga Njësia e Shërbimit Ligjor, këshilltarët ligjorë e ekonomikë të së cilës studiojnë dosjen nga pikëpamja financiare/ekonomike dhe hartojnë relacionin e çështjes, sipas përcaktimeve të nenit 23 të ligjit nr. 84/2016. Ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar në asnjë dispozitë të tij thirrjen e ndonjë eksperti për efekt të rivlerësimit, por ka parashikuar Njësinë e Shërbimit Ligjor, si strukturë të posaçme.

19. *Sipas subjektit në ankim, arsyetimi i vendimit të Komisionit është në tejkalim të qëllimit të hetimit dhe në kundërshtim të plotë me përcaktimet e nenit 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, pasi objekt i shqyrtimit të Komisionit është deklarata e pasurisë “vetting”, e plotësuar nga subjekti sipas kërkesave të ligjit dhe vlerësimi sa u përket pasurive të deklaruara, burimeve të ligjshme për krijimin e tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare dhe nxjerrjes së konkluzionit përfundimtar mbi raportin pasuri të ardhura, i cili sipas ligjit nuk duhet të kalojë më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme.*

Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues çmon se në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjektet deklaruese kanë pasur detyrimin të deklarojnë çdo vit në ILDKPKI pasuritë, burimet e krijimit të tyre, të ardhurat, shpenzimet, si dhe detyrimet financiare. Komisioni, në kuadër të procesit të rivlerësimit të pasurisë, përveç deklaratës së pasurisë “vetting” dhe dokumentacionit që justifikon vërtetësinë e deklarimeve, administron të gjithë dokumentacionin ligjor të vënë në dispozicion nga institucionet publike sipas kërkesave të neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklaratat e interesave privatë periodikë, që sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 5 e këtij ligji mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit. Në lidhje me procesin e rivlerësimit të pasurisë, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklaratimet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke qenë se përcaktimet kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara u kanë dhënë deklarimeve periodike të pasurisë vlerën e provës, Komisioni apo Kolegji këto deklarata, së bashku me provat e tjera, i vlerëson në tërësi dhe harmoni me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë.

Për sa i përket pretendimit lidhur me deklarimin *më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme*, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vendimi nr. 136, datë 09.04.2019, është bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilave shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore kur rezulton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të këtij ligji. Komisioni, siç është përcaktuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, shkarkon subjektin e rivlerësimit në kuadër të një vlerësimi tërësor të të tria kritereve e të procedurave, për sa kohë që institucionet e rivlerësimit çmojnë se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, për masën e shkarkimit nga detyra të subjektit, ka zbatuar pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe jo pikën 1 të nenit 61 të tij, i cili përlligj shkarkimin nga detyra kur rezulton se subjekti së bashku me personat e lidhur kanë deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme. Sa më sipër, pretendimi i subjektit se Komisioni ka tejkaluar qëllimin e hetimit dhe zbatimit të ligjit, është i pabazuar.

20. Nga shqyrtimi i procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se

nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1³ e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për të legjitimuar zhvillimin e gjykimit me praninë e palëve në seancë gjyqësore publike.

21. Për arsyet e analizuara më sipër, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

III/2. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit për këtë kriter

22. Subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049”) dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367”), ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë.
23. ILDKPKI, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit, me shkresën nr. {***}prot., datë 10.01.2018, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Fehmi Petku, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, duke arritur në konkluzionin se:
 - i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ii. nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii. ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv. ka kryer deklarim të rremë;
 - v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
24. Nisur nga aktet shkresore që janë administruar në dosjen gjyqësore, si dhe shkaqet në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit kryen kontrollin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, duke u dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kriteret që parashikojnë dispozitat e mësipërme.

Për pasurinë truall me sipërfaqe 372 m² dhe banesë mbi këtë truall, e përbërë nga tri kate, bodrum, papafingo, ndodhur në rrugën “{}”, nr. {***}, Tiranë***

25. Në lidhje me këto pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionet:

³ Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012: “Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji;

b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankim është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;

c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë”.

- i. *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive, në kundërshtim me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.*
- ii. *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e përdorur për krijimin e pasurive.*
- iii. *Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.*
- iv. *Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.*

26. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet e administruara në dosje, lidhur me krijimin dhe ndryshimet ndër vite të kësaj pasurie, konstaton sa vijon.

- Me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 09.09.1960, sipas vendimit nr. {***}, datë 24.08.1960, Komiteti Ekzekutiv i Qytetit Tiranë i shet A. P parcelën e tokës me nr. {***}, me sipërfaqe 372 m², në vlerën 7440 lekë. Nëpërmjet lejes së ndërtimi nr. {***}, datë 18.3.1961, të Komitetit Ekzekutiv të Qytetit të Tiranës, vendoset ndërtimi i objektit shtëpi banimi me 1 kat. Sipas subjektit të rivlerësimit, në vitin 1967 familja Petku internohet në fshatin {***}, Berat, e më pas në vitin 1974 zhvendoset në fshatin {***}, Kukës. Në prill të vitit 1991, familja Petku fiton të drejtën për t'u rikthyer përsëri në banesën e ndërtuar në vitin 1961, në Tiranë, në adresën e mësipërme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. {***}, datë 13.03.1992, vërteton faktin juridik të pronësisë së A. P si pronar i kësaj banese, vendim i cili regjistrohet pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me nr. regjistri {***}, nr. rendor {***}, datë 17.03.1992, me përshkrimin: *një shtëpi në rrugën “{***}”, nr. {***}, Tiranë, e cila përbëhet nga dy dhoma, një kuzhinë, një korridor, banjo dhe oborr [...].*

- Kjo banesë njëkatëshe, me sipërfaqe 80 m², është shembur, sipas deklarimeve të vetë subjektit, në vitet 1993-1994 dhe mbi truallin e saj është ndërtuar objekt me tri kate, bodrum dhe papafingo, në vitet 1994-1995, siç përcaktohet dhe në vendimin nr. {***}, datë 29.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me të cilin është njohur pronësia e kësaj shtëpie banimi, dhe regjistruar në ZRPP Tiranë, me nr. regjistri {***}, nr. rendor {***}, Tiranë, më datë 04.03.1996.
- Më datë 19.04.1996, pronari i kësaj pasurie/babai i subjektit të rivlerësimit A. P, i përfaqësuar me prokurë te posaçme nga i biri S. P, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., ia shet këtë banesë z. V. A, në vlerën 520000 USD.
- Pronësia e kësaj banese i është njohur përsëri A. P me vendimin nr. {***}, datë 04.11.2002, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 13.01.2005.
- Me miratimin e hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve informale”, i ndryshuar, babai i subjektit, z. A. P, depoziton vetëdeklarimin për legalizimin e objektit, nr. {***} prot., më datë 24.10.2006.
- **Më datë 18.06.2015, lëshohet dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., sipas së cilës trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit A. P, janë Xh. P, S. P, I. P, Fehmi Petku, që përfitojnë nga trashëgimia në pjesë të barabarta me ¼ (një të katërtën) pjesë secili.**
- Në përfundim të procedurave të legalizimit, lëshohet “Leja e legalizimit” nr. {***}, datë 05.05.2016, për këtë objekt, në emër të Fehmi Petku, Xh. P, S. P dhe I. P, ndodhur në zonën kadastrale {***} dhe nr. pasurie {***}, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 454,9 m²,

sipërfaqe totale të ndërtimit për banim 1100,4 m². Kjo pasuri është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sa konfirmohet me shkresën nr. {***}prot., datë 15.02.2018, të ZVRPP Tiranë, sipas lejes se legalizimit.

27. Nga shqyrtimi i çështjes në Kolegj, për këtë pasuri, trupi gjykues ka konstatuar si më poshtë. Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi:
*Pasuri të paluajtshme të fituara si trashëgimtar ligjor i babait tim A. S. P. Dëshmi trashëgimie nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 18.06.2015.*
*Truall me sipërfaqe 372 m². Kontratë shitblerje nr. {***}, datë 09.09.1960. Shitës Komiteti Ekz. Tiranë – Blerës A. S. P. Regjistruar në ZRPP Tiranë. Certifikatë pronësie me nr. {***}. Nr. Pasurisë {***}, zona kadastrale {***}, volume {***}, faqe {***}. 7440 lekë vlera e blerjes në shtator 1960. Pjesa takuese ¼.*
Banesë mbi truallin e mësipërm, e përbërë nga tri kate, bodrum dhe papafingo. Ndërtuar 1994-1995. Legalizuar me proces legalizimi pranë ALUIZNIT Tiranë (procedurë e nisur që nga viti 2006, sipas dosjes përkatëse të ALUIZNIT bashkëlidhur). Regjistruar në regjistrat e ZRPP Tiranë. Sipërfaqe totale ndërtimi 1150 m².
*Adresa: lagjja nr. {***}, rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë. Certifikatë pronësie me nr. {***}. Nr. Pasurisë {***}, zona kadastrale {***}, volume {***}, faqe {***}. E ndërtuar nga babai im, trashëgimlënësi A. S. P, në vitet '93-'94-'95. E pavlerësuar deri në këto momente. Pjesa takuese ¼”.*
Këto pasuri janë deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2015, pas çeljes së trashëgimisë dhe lëshimit të “Dëshmi trashëgimie nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 18.06.2015”, deklaruar po njësoj edhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016 e në vazhdim. Nga analizimi i dy deklarimeve më sipër, trupi gjykues konstaton se për të gjithë pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, të cilat i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit në Komision, është pretenduar nga subjekti si burim krijimi përfitimi me anë të trashëgimisë ligjore.
28. Trupi gjykues, gjatë analizës së tij në fillim është ndalur për të përcaktuar marrëdhënien juridike që subjekti i rivlerësimit ka me këtë pasuri, banesë e ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë.
29. Së pari, nga analizimi i akteve shkresore të dosjes, deklarimeve periodike nga viti 2003 e në vazhdim, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka banuar në katin e parë të kësaj banese që nga ndërtimi i saj, në vitin 1995 deri aktualisht, si është deklaruar nga subjekti *duke mos u larguar asnjëherë prej saj*. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 15.10.2018 të pyetësorit shtesë të Komisionit, deklaroi kontributin e tij në ndërtimin e kësaj banese, *kontributi im konsiston vetëm në ndihmën e dhënë me të ardhura nga paga ime gjatë periudhës 1978-1992, të ardhura të cilat administroheshin nga kryefamiljari A. P. [...].Edhe dy vëllezërit e mi, S. dhe I. P, ashtu si dhe unë, kanë kontribuar me të ardhurat nga paga e tyre për periudhën 1980-1992*. Sa më sipër, të krijon bindjen se nuk ndodhemi në kushtet e një rasti të mirëfilltë të trashëgimisë, pasi subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në ndërtimin e banesës me tri kate, bodrum e papafingo, të ndodhur në rrugën “{***}”, së bashku me babain dhe vëllezërit e tij, ka banuar në të që prej ndërtimit në vitin 1995 e aktualisht, duke investuar, duke e përdorur dhe në përfundim ka fituar pronësinë në pjesën ¼ të saj.
30. Në mbështetje të kësaj situatë faktike, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, përkatësisht në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuptim të nenit D të Aneksit të

Kushtetutës, ka pasur detyrimin ligjor të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe të pasurive të tjera të krijuara nga shitja e saj, si pasuri të krijuara edhe me kontributin e tij.

31. Në ndryshim nga Komisioni, i cili ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar me të ardhura nga burime të ligjshme pasuritë e blera dhe të krijuara për periudhën 1994-1996, në Kolegj u krye analiza financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të babait të subjektit A. P, në cilësinë e kryefamiljarit, për të justifikuar me të ardhura nga burime të ligjshme pasuritë e blera dhe të krijuara për periudhën 1978 – 31.12.1995, kohë e cila përcakton përfundimin e ndërtimit të pasurisë në fjalë, me konsideratë të ardhurat nga pagat të babait të subjektit, subjektit të rivlerësimit dhe vëllezërve të tij, si pretenduar nga subjekti dhe për të cilat ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor.

Për të shpjeguar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie dhe koston e ndërtimit të saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkaqe ankimore të analizuarra më poshtë.

32. Subjekti pretendon në ankim se Komisioni ka përllogaritur në mënyrë të pasaktë sipërfaqen e përgjithshme të banesës, prej 1351,4 m², duke shtuar gabim sipërfaqen prej 251 m² të katit përdhe, llogaritur dy herë, fakt lehtësisht i verifikueshëm, me dokumentacionin hipotekor (kartela e pasurisë ku pasqyrohen këto të dhëna).

Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni, në analizën e paraqitur me rezultatet e hetimit, ka konsideruar sipërfaqe totale të banesës 1351,4 m², sipas të dhënave të kartelës së pasurisë, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2018, nga ZVRPP Tiranë, duke përllogaritur kështu dy herë sipërfaqen e katit përdhe prej 251 m², gabim i konstatuar edhe në raportin dërguar Komisionit nga ILDKPKI. Në analizën financiare pas prapësimeve të subjektit, si pasqyrohet në paragrafin 47.1 të vendimit, “Analiza financiare, periudha 1994-1996”, Komisioni në përfundim ka përllogaritur koston e ndërtimit të banesës në vlerën 14815450 lekë, me konsideratë sipërfaqe totale banimi 1150 m², si deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, që korrespondon dhe me sipërfaqen në “Të dhënat e pasurisë”, regjistruar në ZRPP Tiranë, me nr. regjistri {***}, nr. rendor {***}, datë 27.04.1996, ashtu siç pretendon subjekti. Sa më sipër, ky pretendim nuk qëndron si shkak ankimi.

32.1 *Pretendimin e subjektit të rivlerësimit që nuk është arsyetuar nga Komisioni se gfarë përfaqëson diferenca në vlerën 2594636 lekë, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi diferenca më sipër është krijuar nga përllogaritja e gabuar e sipërfaqes së ndërtimit të banesës në analizën dhënë subjektit me rezultatet e hetimit dhe atë pas prapësimeve, duke konsideruar në këtë të fundit kosto ndërtimi për sipërfaqe 1150 m² në vlerën 14815450 lekë (1150 m² x 12883⁴ lekë/m²).*

32.2 *Subjekti pretendon në ankim se, sipas ekspertëve të licencuar, sipërfaqja e papafingos nuk mund të konsiderohet sipërfaqe ndërtimi dhe, për rrjedhojë, edhe vlera e përllogaritur e saj duhet zbritur nga shuma totale e koston së ndërtimit, në vlerën 175,9 m² x 12883 lekë/m² = 2266.119 lekë.*

⁴ Përcaktuar në vendimin nr. 815, datë 9.12.1996, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vleftave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vleftës së koeficientit “K”.

Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes, konstaton se në kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.1996, të nënshkruar mes z. A. P dhe z. V. A, përcaktohet një shtëpi [...] me përbërje bodrume dhe tri kate, ndërtuar me mur tulle, e suvatuar nga jashtë, në fasadë, ku në çdo kat ka pesë dhoma, kuzhinë, korridor, dy banjo dhe verandë, si dhe papafingo në çati. Në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me nr. regjistri {***}, nr. rendor {***}, më datë 27.04.1996, kjo ndërtesë është regjistruar shtëpi banimi, e përbërë nga bodrum dhe tri kate banimi, me përbërje çdo kat 5 dhoma, kuzhinë, korridor, verandë, dy banja, si dhe papafingo në çati, me sipërfaqe totale ndërtimi 1150 m².

Në formularin e vetëdeklarimit për legalizim, të depozituar nga A. P, përcaktohet se objekti informal që do t'u nënshtrohet procedurave të legalizimit, i ndërtuar në vitin 1995, është i përbërë nga 4 (katër) kate dhe 1 (një) kat nëntokë. Pra, vetë poseduesi i këtij objekti ka përcaktuar papafingon si kat dhe e ka përfshirë në sipërfaqe totale banimi.

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, vetë subjekti deklaroi se banesa ka një sipërfaqe totale ndërtimi prej 1150 m², pra duke përfshirë në sipërfaqen totale të ndërtimit edhe sipërfaqen e papafingos.

Nga sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se *papafingoja* ka ekzistuar me ndërtimin e banesës në vitin 1995, është përfshirë në sipërfaqen totale të ndërtimit sipas regjistrimit të pasurisë nr. {***}, nr. rendor {***}, më datë 27.04.1996, në ZRPP Tiranë, është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, për pasojë, kjo sipërfaqe duhet përfshirë në përllogaritjen e koston totale të ndërtimit të banesës objekt vlerësimi.

32.3 Subjekti pretendon në ankim se Komisioni, në përllogaritje, nuk ka marrë parasysh udhëzimin nr. 21, datë 26.02.2009, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, sipas të cilit për ndërtesat e ndërtuara nga vetë individët, çmimi për m² është 70% e vlerës reale, vlerë me të cilën duhet përllogaritur sipërfaqja për tri katet dhe të zbritet diferenca nga vlera e përllogaritur nga ekspertët e Komisionit. Ekspertët e Komisionit nuk kanë marrë parasysh udhëzimin e mësipërm edhe në përllogaritjen e koston për sipërfaqen 193,1 m² bodrum, e cila duhet llogaritur me 70% të vlerës, në raport me vlerën e sipërfaqes për banim 193,1 m² x 12883 lekë/m² x 70% e ndërtuar vetë) x 70 % si sipërfaqe bodrumi) = 1.218.977 lekë.

Për pretendimin më sipër, trupi gjykues vlerëson se udhëzimi nr. 21, datë 26.02.2009, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2008 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme", ku bazohet subjekti i rivlerësimit, nuk ka objekt përcaktimin e koston së ndërtimit për m², por përcaktimin e çmimit të shitjes së pasurisë për efekt të përcaktimit të detyrimit tatimor në kalimin e së drejtës së pronësisë. Në vijim të arsytimit, përcaktimi në pikën 5, germa "e" e këtij udhëzimi: *për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, për ndërtesat e ndërtuara nga vetë individët dhe të regjistruara deri më 31 dhjetor 2004, çmimi për 1 m² është 70 për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë, nuk mund të zbatohet në rastin konkret dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përdoret si argument mbështetës nga subjekti.*

32.4 Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim se, nga kostoja e ndërtimit të këtij objekti duhet zbritur vlera e materialeve të shtëpisë së vjetër të përdorur, në vlerën 241.600 lekë, trupi gjykues konstaton se në raportin e vlerësimit të sjellë nga subjekti, të përgatitur nga vlerësuesit e pasurive të paluajtshme, P. K dhe Sh. A, rezultoi që nga vlera e koston së ndërtimit zbritet vlera e materialeve gjendje, si gurë e tulla të përfituara nga prishja e shtëpisë njëkatëshe, duke përcaktuar: gurë, 48 m³ x 1000 lekë = 48.000 lekë; tulla, 44 m³ x 440 copë/m³ x 10 lekë/copë = 193.600 lekë. Shuma: 241.600 lekë.

Trupi gjykues konstaton se të dhënat në raportin e vlerësimit të paraqitur nga subjekti, janë të paplota, nuk shoqërohen me dokumentacion teknik që të përcaktojë metodologjinë e përdorur në përlllogaritjen e sasisë së tullave dhe gurëve, nuk jepen referencat teknike ku është mbështetur eksperti në përcaktimin e materialeve për m³, nuk jepet raporti i amortizimit të materialeve gjatë prishjes së ndërtesës së parë, aq më tepër kur në vendimin nr. 8914, datë 28.02.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përcaktuar se, *meqenëse kërkesat e paditësit (A. P) për strehim kanë qenë të ngutshme, me leje të organit kompetent shtetëror, ka ndërtuar një shtëpi banimi, pasi e ka prishur shtëpinë e vjetër që ka qenë shumë e rrënuar [...]*. Referuar raportit të vlerësimit, çmimi i tullës/copë është përlllogaritur 10 lekë, ndërsa nëse i referohemi vendimit nr. 201, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e çmimeve të tullave dhe të çimentos”, çmimi i një tulle të plotë teke është përcaktuar 7,5 lekë/copa. Pra, në raportin e vlerësimit nuk përcaktohet referenca në të cilën është mbështetur vlerësuesi për përcaktimin e vlerës së materialeve të ndërtimit. Sa më sipër, pretendimi i subjekti nuk mund të merret në konsideratë.

32.5 *Sa i përket pretendimit të subjektit në ankim, se në vlerën e ndërtimit të këtij objekti duhen zbritur vlera e punimeve të papërfunduara plotësisht në banesë, në shumën 2898758 lekë, trupi gjykues konstaton se nga analizimi i akteve shkresore në dosje, si kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.1996, me palë shitëse A. P (përfaqësuar me prokurë të posaçme nga i biri S. P) dhe blerës V. A, dokumenti “Të dhënat e pasurisë” të ZVRPP Tiranë sipas regjistrimit të banesës nr. {***}, nr. rendor {***}, datë 27.04.1996, apo vendimi nr. {***}, datë 28.02.1996, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, me të cilin A. P është njohur si pronar i ndërtesës së ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, pa specifikuar në asnjë rast që ndërtesa është karabina, pjesë e pandërtuar apo ka punime në proces. Referuar raportit të vlerësimit të depozituar nga subjekti, të përgatitur nga vlerësuesit e zgjedhur prej tij, rezulton se është zbritur vlera e punimeve të papërfunduara në vitin 1994-1995, në shumën 2898758 lekë, por në asnjë rast nuk janë specifikuar dokumentet financiare, si: fatura për blerje materiale apo kryerje punimesh, mbi bazë të të cilave është mbështetur ky vlerësim. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.*

32.6 *Subjekti pretendon në ankim se Komisioni nuk ka marrë parasysh në përlllogaritjen e kostos së ndërtimit të kësaj banese, ndihmën e dhënë nga shoqata {***}, në vitin 1994, në materiale ndërtimi, e cila pas konfirmimit nga Shoqata {***}, ka një vlerë prej 750000 lekësh. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision vërtetimin nr. {***} prot., datë 26.03.2019, të lëshuar nga Shoqata {***}, në të cilin citohet: *Vërtetojmë se familjes së A. P, në vitin 1994, si ish-i përndjekur politik, nga ana e shoqatës “{***}”, i është dhënë ndihmë falas në material ndërtimi, në një vlerë 750000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për ndërtimin e shtëpisë së tij në Tiranë, si: tulla, llac, cemento etj. Ky vërtetim lëshohet me kërkesë të djalit të tij, z. Fehmi Petku, për ta paraqitur para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.* Trupi gjykues vlerëson se së pari, ky vërtetim nuk është lëshuar nga {***}⁵, si shoqata që pretendohet të ketë ofruar ndihmën në materiale ndërtimi, por nga Shoqata e {***}, duke mos evidentuar marrëdhënien juridike midis kësaj shoqate dhe {***}-it, në emër të të cilit lëshohet ky vërtetim. Së dyti, ky vërtetim nuk është shoqëruar me asnjë dokument provues financiar apo preventiv, për të ndarë në zëra materialet e ndërtimit të vëna në dispozicion dhe llogaritjen e vlerës monetare të tyre. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.*

⁵ Catholic Agency For Overseas Development (CAFOD).

32.7 Subjekti pretendon në ankim se Komisioni nuk ka marrë parasysh kontributin e dhënë nga të gjithë familjarët në kryerjen e zërave të ndryshëm të punimeve, si dhe punëve të shumta ndihmëse, kontribut i cili ka qenë i konsiderueshëm, për faktin se familja përbëhej nga numër i madh pjesëtarësh, ndërkohë që babai dhe vëllezërit kanë qenë me kualifikim të lartë në fushën e ndërtimit (të tre teknikë ndërtimi) kontribut i cili konvertohet në vlera monetare të konsiderueshme. Trupi gjykues, lidhur me këtë pretendim, vlerëson se në kushtet kur kontributi në kryerjen e zërave të ndryshëm të punimeve, si dhe punëve të shumta ndihmëse, është një kontribut i dhënë në natyrë dhe i pamatshëm, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit, subjekti duhet të kishte depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar kontributin e dhënë, të konvertuar në vlera monetare. Nisur nga fakti që subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor, ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare të kryer në Komision apo Kolegj.

32.8 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga paga e babait A. P, paga e subjektit dhe vëllezërve S. dhe I. P për periudhën 1980-1992, me të ardhura mujore në vlera 30 mijë deri 40 mijë lekë të vjetra, të cilat, sipas vërtetimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për këtë periudhë arrijnë vlerën totale 3562.380 lekë. Këto të ardhura kanë krijuar një buxhet familjar të akumuluar ndër vite, buxhet i cili ishte planifikuar për të zgjidhur problemin e strehimit të familjes.

Lidhur me këtë pretendim, referuar dokumentacionit justifikues ligjor të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, nga përlllogaritjet e kryera në Kolegj, rezulton që të ardhurat neto të babait të subjektit, subjektit dhe vëllezërve të tij, për periudhën 1978-1995, arrijnë vlerën 649.375 lekë dhe jo 3562.380 lekë, sa pretendon subjekti, duke mos qenë të qartë nëse vlera e shprehur prej tij është në lekë të rinj apo të vjetër.

*32.9 Subjekti pretendon në ankim se Komisioni ka shpërfillur kontributin e dhënë nga shoqëria “{***}” ShPK, ndërkohë që kjo shoqëri kishte dy vjet aktivitet dhe objekti kryesor ka qenë fusha e prodhimit të materialeve inerte, të cilat përbëjnë një bazë të konsiderueshme të materialeve ndërtimore, shtuar këtu edhe fakti që shoqëria posedonte edhe një mjet të mjaftueshëm për të përballuar çdo kosto transporti. Kjo shoqëri që në fillimet e saj ka pasur të ardhura të konsiderueshme në dispozicion. Në kushtet kur babai ka qenë administrator dhe pronar i vetëm, çdo e ardhur nga shoqëria është përdorur lirisht prej tij.*

Nga analizimi i dokumenteve të dosjes lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar si person juridik me vendimin nr. {***}, datë 14.06.1994, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me ortak të vetëm dhe administrator A. P, babain e subjektit të rivlerësimit. Kjo shoqëri ka pasur objekt të veprimtarisë prodhimin e materialeve inerte për ndërtim, si dhe tregtimin e këtyre materialeve, import-eksportin e të gjitha llojeve të mallrave ushqimore dhe industriale, si dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të tyre. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 16.07.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë (në vijim: DRT Tiranë), rezulton se shoqëria “{***}” ShPK, për vitin 1995, ka realizuar fitimin pas tatimit të deklaruar, në vlerën 29.111 lekë. Sipas kësaj shkrese, shoqëria “{***}” ShPK, nuk rezulton të ketë shpërndarë dividend për vitin 1995. Po kështu, referuar paragrafit 3 të raportit të shoqërisë audituese “{***}” ShPK, *Kontrollit të kapitaleve të veta*, rezulton se rritja e kapitaleve të veta, nga 6.000.000 lekë në 9.400.448 lekë, ka ardhur nga fitimet e mbartuara për periudhën 1994-2000 dhe provizionet e krijuara. Nga sa më sipër, rezulton që shoqëria të mos ketë tërhequr fitimin neto prej vitit të

krijimit 1994 deri në vitin 2000, por ta ketë akumuluar atë. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson që kjo shoqëri të mos ketë pasur të ardhura të konsiderueshme si pretendon subjekti, të cilat të kenë shërbyer si burim krijimi për banesën e ndërtuar në vitet 1994-1995, për më tepër nuk provohet me dokumentacion justifikues fakti që mjetet apo materialet e shoqërisë të jenë përdorur për ndërtimin e banesës objekt analizimi.

33. *Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të fakteve, siç detyron ligji nr. 84/2016, përkundrazi me keqdashje ka përllogaritur vlerën e kësaj pasurie në vlerë më tepër nga ajo reale, trupi gjykues, për sa arsyetuar më sipër, vëren se Komisioni ka përllogaritur vlerën e kësaj pasurie duke konsideruar sipërfaqen totale të banimit 1150 m², sipas të dhënave të pasurisë regjistruar në ZVRPP Tiranë në vitin 1996 dhe deklarimeve të vetë subjektit në deklaratat e interesave privatë të viteve 2015, 2016 e vetting, shumëzuar me kosto ndërtimi 12.883 lekë/m² për qytetin e Tiranës, si përcaktuar në vendimin nr. 815, datë 9.12.1996, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlefave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vlefës së koeficientit “K”, për pasojë pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.*
34. *Në ndryshim nga Komisioni, bazuar në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar dhe vlerësimin ligjor më sipër, u krye në Kolegj analiza financiare për të vlerësuar mundësinë e kryefamiljarit A. P, subjektit të rivlerësimit dhe vëllezërve të tij që, me të ardhurat nga burime të ligjshme për periudhën 1978 -1995, të justifikojnë ndërtimin e banesës me sipërfaqe 1150 m², të ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, në vitet 1994-1995, pasuri të tjera të krijuara, si dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës së analizuar. Rezultatet e analizës financiare të kryer, treguan mungesë të burimeve financiare të kryefamiljarit, subjektit dhe vëllezërve, në vlerën 15.149.162 lekë. Edhe nëse do të konsideronim pretendimin e subjektit se kostoja e ndërtimit të kësaj banese do të ishte në vlerën 3.785.382 lekë, përsëri rezulton mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 4.121.094 lekë, përllogaritur si diferencë e të ardhurave neto në vlerën 694.875,5 lekë⁶ me shpenzimet jetike në vlerën 428.588 lekë⁷, minus vlerën e pasurive të krijuara në periudhën e analizuar 4.387.382 lekë⁸, pa konsideruar koston e objektit me sipërfaqe 30 m², mure rrethuese 70 m dhe garazhin me sipërfaqe 160 m², deklaruar në formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e këtij objekti, si të ndërtuara në vitin 1995, por ende të palegalizuara.*
35. *Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si në deklaratën e pasurisë vetting, ashtu edhe në deklaratat e interesave privatë, se kjo pasuri e paluajtshme është përfutur me trashëgimi ligjore, si provuar nga aktet shkresore të administruara, në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarim të rremë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.*
36. ***Në përfundim, për këtë pasuri, truall dhe banesë e përbërë nga 3 kate, bodrum dhe papafingo, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33,***

⁶ Në të ardhura nga burime të ligjshme janë përfshirë edhe shumat e kthyera A. P. dhe Fehmi Petkut me dekretin e Presidentit nr. {***}, datë 14.02.1994, në vlerën 45.500 lekë.

⁷ Shpenzimet jetike janë përllogaritur në masën 66% të të ardhurave nga pagat neto dhe pensionet, të realizuara nga kryefamiljari, subjekti dhe vëllezërit e tij, deri në fund të vitit 1995.

⁸ Vlera e pasurive të krijuara në periudhën e analizuar, 4.387.382 lekë, që konsiston në koston e ndërtimit të banesës në vlerën 3.785.382 lekë, si pretenduar nga subjekti, dhe 600.000 lekë, shumë e investuar e kapitalit në natyrë të shoqërisë “{***}” ShPK.

pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

37. Arsyetimi dhe shpjegimi më sipër u bazua në provat e mëposhtme.
- i. Deklarata e pasurisë “vetting” e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI.
 - ii. Deklaratat e interesave privatë periodikë të viteve 2015 dhe 2016.
 - iii. Vendimi nr. {***}, datë 24.08.1960, i Komitetit Ekzekutiv të Qytetit Tiranë.
 - iv. Leje ndërtimi nr. {***}, datë 18.3.1961, e Komitetit Ekzekutiv të Qytetit të Tiranës.
 - v. Vendim nr. {***}, datë 13.03.1992, i Gjykatës së Rrethit Tiranë.
 - vi. Vendim nr. {***}, datë 29.12.1995, i Gjykatës së Rrethit Tiranë.
 - vii. Vendim nr. {***}, datë 04.11.2002, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 13.01.2005.
 - viii. Vërtetim i pronësisë, i lëshuar më datë 05.03.1996, nga Ipoteka, Ministria e Drejtësisë.
 - ix. Dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.06.2015.
 - x. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2016.
 - xi. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 02.03.2016.
 - xii. Raporti i vlerësimit të kryer në mars të vitit 1999, për llogari të administratorëve të përbashkët të shoqërisë “{***} ShPK.
 - xiii. Certifikatë familjare e datës 12.10.2018, sipas së cilës S., I. dhe Fehmi janë veçuar nga familja në datën 30.04.1992.
 - xiv. Vërtetim i lëshuar nga Shoqata {***}, nr. {***} prot., datë 26.03.2019.
 - xv. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.07.2018, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë.
 - xvi. Shkresë nr. {***} prot., datë 15.02.2018, e ZVRPP, Tiranë, dokumentacion bashkëlidhur.
 - xvii. Leje legalizimi nr. {***}, datë 05.05.2016, lëshuar nga ALUIZNI.
 - xviii. Vetëdeklarimi për legalizim, i depozituar nga babai i subjektit, nr. {***} prot., datë 24.10.2006.
 - xix. Raporti i vlerësimit të sjellë nga subjekti, i përgatitur nga vlerësuesit e pasurive të paluajtshme, P. K dhe Sh. A.
 - xx. Kontratë e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.1996, me palë shitëse A. P (përfaqësuar me prokurë të posaçme nga i biri S. P) dhe V. A.
 - xxi. Shkresa nr. {***} prot., datë 21.02.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dokumentacioni shoqërues.
 - xxii. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

Për pasurinë shtëpi banimi, e përbërë nga dy kate banimi dhe bodrum, me sipërfaqe 130 m², ndodhur në fshatin {*}, Tiranë**

38. Komisioni në lidhje me këtë pasuri, ka arritur në përfundimet e mëposhtme.
- i) Trupi gjykues çmon se mospërputhjet e deklaratës noteriale të depozituar me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, janë fakte që vijnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
 - ii) Shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.
 - iii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

39. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti për herë të parë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, *truall me sipërfaqe 6000 m², blerë me kontratat e shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 14.08.1996. [...] shitës K. B, blerës A. P, sipërfaqe 4000 m², çmimi 1500 lekë për m². Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.1996 [...], shitës N. B., blerës A. P, sipërfaqe 2000 m², çmimi 1500 lekë për m². Adresa për dy sipërfaqet e mësipërme, fshati {***} Tiranë. Pronat e mësipërme nuk figurojnë të regjistruara në regjistrat e ZRPP Tiranë. Sipërfaqja faktike, sipas dy kontratave të mësipërme, është 5300 m², sipërfaqe për të cilën është kryer dhe pagesa e plotë në vlerën 5300 m² x 1500 lekë = 7950000 (shtatë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Pjesa takuese 1/4.*
Tre shtëpi banimi të ndërтуara mbi truallin e mësipërm, secila nga dy kate banimi dhe bodrum, me sipërfaqe kati 130 m². Të tria banesat e mësipërme janë të paregjistruara në regjistrat e ZRPP Tiranë, ndodhen në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t, Tiranë. Të pavlerësuara deri në këtë moment. Pjesa takuese 1/3.
 Në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe deklaratën e pasurisë për rivlerësim *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi sipërfaqe të njëjtë truall si në deklaratën e vitit 2015, ndërsa për sa u përket pasurive të paluajtshme ndërтуar mbi këtë truall, deklaroi: *një shtëpi banimi e ndërтуar mbi truallin e mësipërm, e përbërë nga dy kate banim dhe bodrum, me sipërfaqe kati 130 m². Banesa e mësipërme ka përfunduar procesin e legalizimit, proces i cili ka filluar në vitin 2005, mbi bazën e vetëdeklarimit të bërë nga babai im, trashëgimlënësi A. S. P. Kjo banesë ka kaluar në emrin tim gjatë procedurave të legalizimit, mbi bazën e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.06.2015 [...], si dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2016 [...], me të cilën trashëgimtarët e tjerë ligjorë të trashëgimlënësit A. S. P, kanë hequr dorë nga çdo pretendim pronësie mbi këtë banesë dhe legalizimin e saj vetëm në emrin tim. Kjo banesë aktualisht ndodhet në proces regjistrimi, në ZRPP Tiranë. E pavlerësuar deri më sot. Pjesa takuese 100%.*
40. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se të gjitha pasuritë e paluajtshme në emër të tij janë fituar me anë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.06.2015, si deklaruar dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike të interesave privatë të viteve 2015 dhe 2016. Sa u përket tri godinave të banimit të ndodhura në fshatin {***}, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit shtesë të Komisionit, të datës 15.10.2018, ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e truallit 6000 m² dhe për ndërtimin e fazës së parë të tri godinave të banimit, *të ardhurat nga shitja e banesës në rr. "{***}", nr. {***} dhe të ardhurat nga kontrata e huas, e lidhur me shoqërinë "{***}" ShPK, më datë 27.04.1996.* Si arsyetuar në paragrafët 29 dhe 30 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka kontribuar për ndërtimin e banesës në rr. "{***}", Tiranë dhe, nisur nga fakti që të ardhurat nga shitja e kësaj banese kanë shërbyer si burim krijimi për godinën/~at në fshatin {***}, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku ka pasur detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
41. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe arsyetimin si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit kreu analizën financiare për të vlerësuar nëse babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të ndërтуar tri godinat në fshatin {***}, Tiranë, me të ardhura nga burime të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon që godinat më sipër të jenë ndërтуar në dy faza kohore të ndryshme dhe si burim krijimi të tyre, përveç të ardhurave nga shitja e banesës në rr. "{***}", Tiranë, pretendon edhe të tjera burime financiare, analizuar më poshtë në këtë vendim.

42. Sa i përket sipërfaqes dhe vlerës së trullit objekt shqyrtimi, u analizuan kontratat e shitblerjes, nga ku rezultoi se A. P, babai i subjektit të rivlerësimit, ka blerë dy sipërfaqe trualli, 4000 m² dhe 2000 m², përkatësisht me çmim 1500 lekë/m², në vlerën totale 9.000.000 lekë. Subjekti, në deklaratat e interesave privatë të viteve 2015, 2016 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaroi se sipërfaqja faktike sipas dy kontratave të mësipërme është 5300 m² sipërfaqe, për të cilën është kryer dhe pagesa e plotë në vlerën 5300 m² x 1500 lekë = 7.950.000 lekë. Pra, subjekti deklaroi vlerë të paguar për blerjen e dy trojeve 7.950.000 lekë, ndërkohë që vlera totale sipas kontratave ka qenë 9.000.000 lekë. Në vlerësimin e trupit gjykues në Kolegj, është marrë në konsideratë vlera 9.000.000 lekë, e paguar si specifikuar në dokumentacionin justifikues ligjor, kontratat respektive të administruara.
43. Sipas informacionit të përcjellë nga ALUIZNI, Drejtoria Tiranë Jug, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.02.2018, shtetasi A. P, babai i subjektit të rivlerësimit, figuron vetëdeklarues pranë Njësisë Administrative Nr. {***}, aplikimi nr. {***} prot., datë 23.03.2005, për qendrën rezidenciale me tri vila të njëjta, sipërfaqe e zënë 5300 m², sipërfaqe e ndërtimit 423 m². Praktika e legalizimit për një nga godinat e banimit (2 kate + 1 kat nëntokë) të qendrës rezidenciale, pas heqjes dorë nga trashëgimtarët e tjerë ligjorë të A. P., me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2016, ka kaluar në emër të subjektit të rivlerësimit Fehmi Petku. Për këtë pasuri të paluajtshme është lëshuar leja e legalizimit nr. {***}, datë 20.10.2016, dhe sipas shkresës nr. {***} prot., datë 15.02.2018, të ZVRPP Tiranë është regjistruar me nr. pasurie {***}, z.k. {***}, sipërfaqe ndërtimi 118 m² dhe sipërfaqja totale banimi 403,9 m².
44. Në lidhje me periudhën e ndërtimit të këtyre banesave, subjekti i rivlerësimit pretendon se ndërtimi i këtyre banesave ka nisur në muajin shtator 1996 dhe ka përfunduar karabina në muajin mars 1997, për shkak të ngjarjeve në Shqipëri, ndërtimi u ndërpre në fazën e karabinasë. Puna për përfundimin e tyre ka rinisur në muajin maj 2002 dhe ndërtimi i plotë i tyre ka përfunduar në muajin shtator 2002, kur u morën me qira nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me seli në Tiranë. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nuk është depozituar dokument ligjor provues që të specifikojë saktësisht ndërtimin e tri godinave në {***} në dy faza, si pretendon subjekti. Në përgjigjet e datës 15.10.2018 të pyetësorit shtesë të Komisionit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nga shitja e banesës në rrugën “{***}”, nr. 15, Tiranë, janë krijuar dhe të gjitha pronat e tjera në vitin 1996 dhe se nga ai vit nuk është shtuar asnjë pasuri tjetër, ndërsa në ankim pretendon që ndërtimi i tri godinave në {***} është kryer në dy faza shtator 1996 – mars 1997 dhe maj 2002 – shtator 2002, kur edhe kanë përfunduar. Sa më sipër, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrime të ndryshme për periudhën e ndërtimit dhe përfundimit të tri godinave objekt shqyrtimi.
45. Në lidhje me kohën e ndërtimit të tri godinave në fshatin {***}, për të provuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në Kolegj u analizuan aktet shkresore në dosje, nga ku rezultoi se në vetëdeklarimin për legalizim, të depozituar nga A. P pranë Njësisë Administrative Nr. {***}, Tiranë, më datë 23.03.2005, për legalizimin e qendrës rezidenciale me tri vila të njëjta, ndërtuar në fshatin {***}, Tiranë, vetëdeklaruesi ka specifikuar si vit ndërtimi vitin 1996. Në dokumentin e vetëdeklarimit nuk përcaktohet ndonjë rubrikë ku kërkohet informacion mbi gjendjen e ndërtesës në momentin e aplikimit për legalizim, karabina/e papërfunduar/e përfunduar/etj., por nisur nga fakti që vetë A. P në vitin 2005 ka vetëdeklaruar vitin 1996 si vit ndërtimi të tri godinave në {***} dhe jo vitet 1996-1997 apo 2002, krijohet bindja që viti 1996 ka qenë viti i ndërtimit dhe përfundimit të këtyre godinave.

46. Subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton arsyetimin në vendim të Komisionit se ndërtimi i vilave në {***} ka përfunduar në vitin 1996, siç vetëdeklaroi A. P në formularin për legalizim, pasi pohimi në vetëdeklarim nuk tregon gjendjen e ndërtimit. Procesi i legalizimit, sipas subjektit, ka përfshirë në shumë raste banesa të papërfunduara plotësisht, në gjendje karabinaje, si parashikuar në nenin 3, germa “a” e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, sipas të cilit *ndërtim pa leje është objekti për të cilin është përfunduar karabinaja*. Nga përmbajtja e dispozitës së mësipërme, për ligjet edhe vetëdeklarimi i bërë nga babai për tri banesat në {***}. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit gjen të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, në kuptim të dispozitës ligjore të cituar nga vetë subjekti, procesit të legalizimit i nënshtrohen edhe ndërtimet në fazën e karabinasë, por nuk gjen të provuar me dokumentacion ligjor pretendimin e subjektit se në vitin 1996, të tria godinat kanë qenë në fazë karabinaje.

47. Në vijim të arsyetimit, për kohën e ndërtimit të tri vilave në {***}, *subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë paraqitur para Komisionit një sërë provash për të provuar se këto banesa nuk janë përfunduar së ndërtuari në vitin 1996, prova të cilat nuk janë marrë parasysh nga Komisioni, pasi nuk gjejnë pasqyrim dhe nuk analizohen në vendim. Provat e paraqitura nga subjekti konsistojnë në:*

47.1 *Foto të depozituara për të provuar se banesat kanë qenë të papërfunduara, në fazë punimesh në vitin 2002, duke e mbështetur këtë pretendim me moshën e fëmijëve të tij, si pjesë e fotove, dhe datën 14 qershor 2002 të stampimit të tyre nga Studio {***}. Për provat më sipër, në kuptim të nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit *provat janë të dhëna që merren prej burimeve dhe sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod dhe ligje të tjera, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces, dhe parashikimeve të nenit 278 të këtij kodi, sipas të cilit, *filmat fotografikë ose filmat kinematografikë, kasetat e çdo lloji, si dhe çdo lloj tjetër regjistrimi, mund të përbëjnë provë për ngjarjet e sendet që janë regjistruar, kur gjykata bindet për saktësinë e vërtetësinë e tyre, trupi gjykues vlerëson se ligjvënësi e lejon marrjen e filmave fotografikë në cilësinë e provës, por ndryshe nga provat ligjore, si: shkresat, ekspertimi, dëshmia, pohimi, për të cilat fuqia provuese është e përcaktuar nga vetë ligji, për filmat fotografikë apo fotografitë, fuqia provuese e tyre është në vlerësim të gjykatës dhe bindjes së brendshme të saj. Data e stampimit 14.06.2002, nga Studio {***}, nuk provon që fotografitë të jenë memorizuar në vitin 2002. Për më tepër, ndërtesat e shfaqura në këto foto, nuk mund të identifikohen me tri vilat objekt analizimi, pasi nuk përmbajnë asnjë element referues si numër banese, emërtim rruge etj., që e provon këtë fakt. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se fotografitë e depozituara nga subjekti i rivlerësimit nuk provojnë pretendimet e tij për kohën e ndërtimit të vilave.***

47.2 *Fatura punimesh dhe shënimesh që vërtetojnë sipas subjektit të rivlerësimit punimet e kryera në vitin 2002, për të cilat pretendon të jenë anashkaluar nga Komisioni dhe nuk janë marrë në konsideratë prej tij në vendim. Lidhur me këtë pretendim, ndodhur në kushtet kur faturat dhe shënimet nuk janë paraqitur në formën e duhur ligjore, mungojnë ekstremitetet në fatura dhe shënimet shpenzimesh/blerjesh të kryera mbajtur me shkrim dore, të cilat mund të hartohen në çdo kohë, të pafirmosura dhe të pashoqëruara me dokumentacion justifikues financiar, trupi*

gjykues vlerëson se nuk mund të merren në cilësinë e provës, sipas qëndrimit⁹ të mbajtur tashmë në Kolegj dhe përcaktimeve të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile.

48. *Subjekti i rivlerësimit e konsideron të padrejtë faktin që Komisioni i referohet në vendimin e tij, vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {***}, datë 17.06.2002, për të provuar se të tria vilat kanë qenë të përfunduara në kohën e vërtetimit të faktit nga gjykata, pasi nga përmbajtja e vendimit gjyqësor, në asnjë rast nuk rezultojnë të dhëna mbi kohën e ndërtimit, ndërkohë që rezulton që tri banesat të jenë ndërtuar nga babai mbi sipërfaqe trualli në pronë të tij. Faktet në vendim sipas subjektit, interpretohen nga Komisioni në mënyrë të padrejtë në disfavor të tij. Në vendimin gjyqësor nuk pasqyrohen elemente të gjendjes së ndërtimit.*

Në vendimin nr. {***}, datë 17.06.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesës dhe vërtetimi i faktit juridik të ndërtimit nga kërkuesi A. P të një kompleksi banimi prej tri vilash 3-katërshe, me konstruksione beton arme, themele betoni, mure tulle dhe të mbuluara me çati, të rrethuara mbi një sipërfaqe trualli pronë e tij prej 5300 m², të ndodhura në Lagjen “{***}”, fshati “{***}”, Tiranë. Nga analizimi i vendimit gjyqësor më sipër, trupi gjykues konstaton se në përmbajtjen e tij nuk jepen të dhëna mbi kohën dhe gjendjen e ndërtimit në datën e marrjes së vendimit, por nisur nga kërkesa për vërtetim fakti të ndërtimit të këtij kompleksi banesash me tri vila, depozituar nga A. P, si ndërtues dhe posedues i tyre, të krijohet bindja që ato kanë qenë të përfunduara në qershor 2002, në ndryshim nga sa pretendon subjekti në përgjigje të pyetësorit se godinat kanë përfunduar në gusht 2002, ndërkohë që në ankim pretendon të kenë përfunduar në shtator të vitit 2002. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.

Bazuar në sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludon ashtu si edhe Komisioni në vendim, se tri ndërtesat e ndodhura në fshatin “{***}”,{***}, Tiranë, janë ndërtuar në vitin 1996.

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për burimin e krijimit të tri ndërtesave të qendrës rezidenciale ndodhur në fshatin “{*}”,{***}, Tiranë:**

49. Subjekti i rivlerësimit pretendon si në ankim, ashtu edhe në përgjigjet e datës 15.10.2018 të pyetësorit shtesë të Komisionit, se si *burim i të ardhurave të përdorura* nga A. P, babai i subjektit, për ndërtimin e tri banesave të qendrës rezidenciale në fshatin “{***}”,{***}, Tiranë, kanë shërbyer:

49.1 Për fazën e parë: *të ardhurat nga shitja e banesës në rr. “{***}” dhe të ardhurat nga kontrata e huas me kompaninë “{***}” ShPK, për periudhën 27 prill 1996 – mars 1997, në shumën totale 359438 USD¹⁰.*

49.2 Për fazën e dytë: *kredi bankare në shumën 150000 USD, e financuar nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë, në gusht 2002, të ardhura nga qiraja e parapaguar për një vit nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë në cilësinë e qiramarrësit, në vlerën 90.000 USD, të ardhura të realizuara nga dhënia me qira e sipërfaqes së tokës në fshatin {***}, Kukës, me*

⁹ Shih paragrafin 39 të vendimit nr. 8, datë 16.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁰Subjekti pretendon si burim krijimi total të ardhura të përdorura për ndërtimin e tri banesave të qendrës rezidenciale në fshatin “{***}”,{***} në vlerën totale 359438 USD = 45.000 USD (vlerë e tërhequr nga çmimi i shitjes së banesës në rr. “{***}”, datë 27.04.1996) + 234438 USD (interesa të tërhequr nga kontrata e huas, datë 27.04.1996) + 80.000 USD (principal i tërhequr më datë 14.02.1997).

misionin {***}, në vitin 1999, në vlerën 6.000.000 lekë, të ardhura nga aktiviteti i shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, si dhe të ardhura nga shitja e sipërfaqes së tokës në vitin 2006, me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.02.2006, në vlerën 740.000 euro.

Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për burimet e krijimit të ndërtimit në fazën e parë të tri ndërtesave të qendrës rezidenciale në {*}, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton:**

50. Nga analizimi i dokumentacionit justifikues të administruar, trupi gjykues konstaton sa vijon.

50.1 Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.1996, shtetasi A. P, i përfaqësuar me prokurorë të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.03.1996, nga i biri S. P, i shet banesën në rr. “{***}” shtetasit V. A në vlerën 520.000 USD, shumë të cilën pala blerëse ia ka likuiduar tërësisht palës shitëse jashtë zyrës noteriale. Sipas përcaktimeve të kontratës, palët bien dakord që banesa të lirohet menjëherë me lidhjen e kontratës së shitblerjes, datë 19.04.1996.

50.2 Më datë 27.04.1996, nënshkruhet kontratë huaje nr. {***}, mes huadhënësit S. P, përfaqësues ligjor i A. P, dhe huamarrësit Kompania {***}, përfaqësuar nga presidenti V. A, për dhënien hua të shumës prej 250.000 USD + 225.000 USD + 800.000 lekësh, me afat 6 muaj dhe interes 8% në muaj.

50.3 Më datë 28.04.1996, një ditë pas nënshkrimit të kontratës së huas së sipërcituar, mes të njëjtave palë lidhet aktmarrëveshja, si aneks i kontratës së huas, ku parashikohet se shtëpia e shitur zotit V. A. të mbahet në përdorim nga zoti A. P dhe familja e tij derisa shoqëria “{***}” të shlyejë detyrimet që ka marrë përsipër me kontratën e huas, datë 27.04.1996. Në aktmarrëveshje, specifikohet se me kontratën e huas, lidhur në datën 27.04.1996, zoti S. P ka depozituar pranë kompanisë “{***}” një pjesë të çmimit të përfituar nga shitja e banesës së babait të tij, konkretisht shumën prej 250.000 USD.

50.4 Nga analizimi i aktmarrëveshjes së datës 28.04.1996, trupit gjykues nuk i rezulton që shoqërisë “{***}” ShPK t’i jetë dhënë hua e gjithë shuma e parashikuar në kontratën e huas nr. {***}, datë 27.04.1996, prej 250.000 USD + 225.000 USD + 800.000 lekë, por vetëm shuma 250.000 USD, e depozituar në arkën e kësaj shoqërie rentiere, më datë 27.04.1996.

50.5 Shoqëria “{***}” ShPK, si shoqëri tregtare, person juridik jobankar, që midis të tjerash ushtronte aktivitetin e marrjes së huas nga publiku i gjerë, u bë objekt kontrolli financiar në kuptim të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe vendimit nr. 325, datë 22.08.1997, të Këshillit të Ministrave, të dalë në zbatim të këtij ligji.

50.6 Administratorët e shoqërisë “{***}” ShPK, në administrim, në zbatim të ligjit nr. 8471, datë 08.04.1999 “Për nxjerrjen e detyrimeve debitore dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me vendimin nr. {***}, datë 31.08.1999, shpallën debitor shtetasin S. P për shumën 7891.200 lekë, dhe vendimi iu përçoll për ekzekutim zyrës së përmbarimit Tiranë, me shkresën nr. {***}, datë 6.07.2000.

50.7 Për detyrimet mes palëve më sipër, në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, u gjykua çështja me paditës, i kundërpaditur: shoqërinë “{***}” ShPK në administrim, i paditur kundërpaditës A. P, përfaqësuar nga S. P me prokurë të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.03.2002,

me objekt padie “Deklarimin e pavlefshëm të kontratës së shitjes nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 19.04.1996 dhe kthimin e shumës 410.000 USD ose 40.442.400 lekë”, dhe objekt kundërpadie “Detyrimin e palës së paditur ta njohë pronar të vetëm të shtëpisë. Anulimin e urdhrin administrativ nr. {***}, datë 14.10.2002, për lirim të banesës”. Në përfundim të gjykimit, gjykata vendosi: *Pranimin pjesërisht të padisë. Deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik, kontratën e shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.04.1996, midis palëve shitës A. P, blerës shoqëria “{***}” dhe kthimin e saj në gjendjen fillestare. Pranimin e kundërpadisë. Shuarjen e detyrimeve ndërmjet palëve ndërgjyqësore shoqëria “{***}” në administrim dhe A. P duke kompensuar detyrimet midis tyre. Detyrimin e palës paditëse – të kundërpaditur shoqëria “{***}” në administrim të njohë pronar të vetëm të banesës që ndodhet në Tiranë, rruga “{***}”, nr. {***} të paditurin – kundërpaditës A. P. Anulimin e aktit administrativ nr. {***}, datë 09.10.2002 dhe nr. {***}, datë 14.10.2002, duke ligjëruar masën për sigurimin e padisë. Vendimi i mësipërm i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 13.01.2005.*

50.8 Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 05.11.2018, përcjellë Komisionit, Shoqërisë Huamarrëse në Administrim, përfaqësuar nga administratori Gj. L., nga kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në shoqërinë “{***}” ShPK dhe nga përpunimi i kartelës së kontratës nr. {***}, datë 27.04.1996, në emër të z. S. P, i ka rezultuar të jenë kryer transaksionet/veprimet financiare derdhje, tërheqje kapitali, tërheqje interesi konkretisht për vitin 1996, janë depozituar 475.000 USD (derdhur më 27.04.1996, shuma 250.000 USD dhe më 25.10.1996, me mandatarkëtimin nr. 695, shuma 225.000 USD), dhe janë tërhequr interesa në shumën 197.200 USD. Ndërsa, në vitin 1997, është tërhequr kapital në shumën 80.000 USD, më datë 14.02.1997, dhe janë tërhequr interesa në shumën 36.891 USD, më datë 03.02.1997. Në total, S. P ka tërhequr kapital, plus interesa në shumën 314.091 USD. Shuma e mbetur si diferencë e shumës së depozituar me shumën e tërhequr, rezulton në vlerën 160.909 USD.

Nga konstatimet dhe analizimi i dokumentacionit të sipërcituar, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se A. P është njohur pronar i vetëm i ndërtesës së ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, me vendim gjyqësor të formës së prerë nr. {***}, datë 13.01.2005, të Gjykatës së Apelit Tiranë, blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 520.000 USD, sipas *kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.1996*, ndërkohë që referuar Raportit të Vlerësimit të kryer nga vlerësuesja e licencuar e pasurive të paluajtshme A. G., më 03.03.1999, për llogari të administratorëve të përbashkët të disa shoqërive¹¹, përfshirë dhe shoqërinë “{***}” ShPK në administrim, me qëllim përcaktimin e numrit të kreditorëve, detyrimeve financiare për t’u paguar, lëvizjen e parave, gjendjen e parave në arkë dhe depozitat në banka të tyre etj., sipas *kërkesave të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe vendimit nr. 325, datë 22.08.1997, të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e personave juridikë që do t’u nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 8227, datë 30.07.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 09.05.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, i ndryshuar, vlera e tregut të kësaj ndërtese ka rezultuar 110.000 USD ose 95.000 USD, nëse merret parasysh që punimet janë bërë nga banorët e shtëpisë. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit del në përfundimin që çmimi i shitjes së ndërtesës me 3 kate, bodrum dhe papafingo në rr. “{***}”, Tiranë, është rreth 4,7 herë më i lartë se vlera e tregut e*

¹¹Për llogari të Administratorëve të Përbashkët të {***} ShPK; {***} ShPK; M. L. ShPK; {***} ShPK; {***} ShPK.

përcaktuar nga vlerësuesja në raportin e vlerësimit.

51. Në vijim të arsyetimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.1996, është nënshkruar nga i biri i z. A. P, S. P, i përfaqësuar me prokurorë të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.03.1996. Nga analizimi i përmbajtjes së prokurës, rezulton se A. P i jep të birit S. P, të drejtë të kryejë për llogari të tij, çdo veprim në lidhje me shitjen e banesës private të ndodhur në Tiranë [...], pra tagrat e përfaqësimit janë dhënë vetëm për të kryer veprimin juridik të shitjes së ndërtesës në rr. “{***}”, Tiranë.
52. Bazuar në arsyetimin ligjor si më lart në këtë vendim dhe në pretendimet e vetë subjektit të rivlerësimit që tri vilat në qendrën rezidenciale në fshatin “{***}”, {***}, Tiranë, janë ndërtuar nga trashëgimlënësi A. P, u krye analiza financiare në Kolegji për të provuar mundësinë financiare të babait të subjektit, për të justifikuar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme ndërtimin këtyre tri vilave në vitin 1996. Në analizën financiare të kryer u morën në konsideratë të ardhurat nga pagat neto të A. P për vitin 1996, të nxjerra nga dokumentacioni justifikues ligjor i administruar, pasi nuk rezultoi që shoqëria “{***}” ShPK të ketë shpërndarë dividend, por e ka akumuluar fitimin neto të realizuar për periudhën 1994-2000; të ardhurat nga shitja e banesës në rr. “{***}” nr. {***}, Tiranë, përfituar me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr {***} kol., datë 19.04.1996; hua në shumën 475.000 USD + 800.000 lekë dhënë shoqërisë “{***}” ShPK sipas kontratës së sipërcituar; si dhe pasuritë e krijuara gjatë vitit 1996¹², bazuar në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar.
- Rezultatet e analizës financiare të kryer, pa konsideruar të ardhurat nga interesat e përfituar nga shumat e dhëna hua, depozituar në shoqërinë “{***}” ShPK, treguan se A. P ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 37.658.048 lekë, por edhe nëse këto interesa do të merreshin në konsideratë, mungesa e burimeve të ligjshme do të zbriste në vlerën 17.050.648 lekë. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
53. Sa i përket kostos së ndërtimit të tri godinave të ndodhura në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit shtesë të Komisionit, deklaroi se nuk disponon dokumente mbi vlerën e investimit, por sipas tij vlera e përafërt e investimit për fazën e parë duhet të ketë qenë 9.000.000 lekë, ndërsa për fazën e dytë 25-30 milionë lekë. Në mungesë të dokumentacionit ligjor për vlerën e ndërtimit të këtyre godinave, Komisioni është bazuar në *koston mesatare vjetore të ndërtimit në shkallë republike, për vitet 1996-1997*, në vlerën 19.581 lekë/m² për sipërfaqe banimi (sipërfaqe shfrytëzimi) të përcaktuar në vendimin nr. 13, datë 05.01.1998, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive”, duke përlllogaritur vlerën e ndërtimit të tri godinave 23.726.298 lekë (1211,7 m² x 19.581 lekë/m²).

¹² Pasuritë e krijuara 01.01.1996 - 31.12.1996, konsistojnë në: tokë bujqësore, {***}, Tiranë, me sipërfaqe 632 m² në vlerën 316.000 lekë, me sipërfaqe 250 m² në vlerën 100.000 lekë, parcelë pjeshkore ({***}) {***}, Tiranë, me sipërfaqe 4500 m² në vlerën 2.250.000 lekë, për sipërfaqen 10.000 m² në vlerën 1.250.000 lekë, tokë bujqësore (Sinane 1912) me sipërfaqe 2000 m² në vlerën 3.000.000 lekë, tokë bujqësore (Sinane 1912) me sipërfaqe 4000 m² në vlerën 5.000.000 lekë (likuiduar deri më 31.12.1996), tokë bujqësore në {***}, Tiranë, me sipërfaqe 6000 m² në vlerën 12.000.000 lekë, dhe tri ndërtesat në {***}, në vlerën 23.726.298 lekë (1211,7 m² x 19.581 lekë/m²), ndërtesë në {***} ndërtuar në vitin 1996, deklaruar për legalizim nga A. P. më datë 11.12.2014, legalizuar me leje legalizimi nr. {***} (193,05 m² për aktivitet kati përdhe dhe 105 m² për banim, kati i parë, në vlerën 5.844.928 lekë.

54. Përlllogaritjet e koston së tri banesave në {***} nga Komisioni, me referencë VKM nr. 13, datë 05.01.1998, subjekti i konsideron të pasakta dhe të gabuara, pasi Komisioni duhet t'i referohej koston për sipërfaqe ndërtimi. Sipas subjektit, Komisioni përdor standarde të ndryshme, pasi pasurinë e parë, banesën në rr. "{***}", e ka vlerësuar me kosto për sipërfaqe ndërtimi, ndërsa vlerësimin e pasurisë së dytë (tri banesat në {***}) e bën kosto për sipërfaqe banimi (shfrytëzimi) që, sipas subjektit, është 22% më e lartë se vlera reale e tyre. Për sa më sipër, subjekti u referohet të dhënave të faqes zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave, ku kostoja e ndërtimit për metër katror në shkallë republike, është pasqyruar 16.138 lekë/m². Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues në vendimin nr. 13, datë 05.01.1998, të Këshillit të Ministrave, konstaton se *kostoja mesatare vjetore në shkallë republike e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitet 1996-1997, të jetë 19.581 lekë/m² sipërfaqe banimi (shfrytëzimi)*, është e dhëna e vetme zyrtare për koston e ndërtimit për vitet 1996-1997, ndërkohë që subjekti i referohet të dhënës në faqen zyrtare të EKB, e cila nuk parashikohet në përmbajtje të Vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar. Edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit, që kostoja për sipërfaqe ndërtimi për metër katror në shkallë republike, për vitin 1996 është 16.138 lekë/m², nga analiza financiare e kryer rezulton që A. P ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për ndërtimin e tri vilave në {***}, Tiranë, në vlerën 32.458.430 lekë, pa marrë në konsideratë interesat e përfutur nga shumat e dhëna hua, depozituar në shoqërinë "{***}" ShPK dhe në shumën 11.851.030 lekë, nëse konsiderohen këto interesa. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.
55. Në përgjigje të pretendimit të subjektit se faza e parë e ndërtimit në gjendje karabinaje e tri banesave në {***}, është bërë në periudhën shtator 1996 – mars 1997, dhe si burim krijim për ndërtimin e tyre kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e banesës në rr. "{***}", Tiranë, dhe të ardhurat nga *interesat bankarë, përfutur nga kontrata e huas, datë 27.04.1996, për periudhën korrik 1996 - mars 1997, në shumën 234.438 USD; vlera e tërhequr nga çmimi i shitjes së banesës në shumën 45.000 USD, datë 27 prill 1996, principal në shumën 80.000 USD, i tërhequr më datë 14.02.1997*, u krye analiza financiare në Kolegji, me konsideratë sa pretendon subjekti lidhur me koston e shpenzuara për ndërtimin e fazës së parë, 9.000.000 lekë në përgjigje të pyetësorit shtesë të Komisionit dhe 10.000.000 lekë në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, të cilat në raport me koston totale përfundimtare të tri objekteve, përbëjnë rreth 42% të saj. Me konsideratë sa më sipër, u krye analiza financiare për periudhën shtator – dhjetor 1996 dhe janar – mars 1997, rezultatet e së cilës treguan se babai i subjektit, z. A. P, justifikon me të ardhurat e realizuara gjatë vitit 1996 shpenzimet e kryera për pjesën e ndërtuar deri në dhjetor të vitit 1996, por nuk justifikon shpenzimet e ndërtimit për periudhën janar – mars 1997, në vlerën 2.170.910 lekë.
56. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit në ankim që Komisioni nuk llogarit si shpenzim vlerën e blerjes së tokës me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në {***}, në vitin 1997, në shumën 12 milionë lekë, pasi në tabelën nën paragrafin 30.1 të vendimit të Komisionit, rezulton të jetë përfshirë në zërin pasuri edhe vlera 12.000.000 lekë¹³ e sipërfaqes së tokës 6000 m², në {***}.

¹³ Kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.1997, me shitës H. M., blerës A. P0, sipërfaqen e tokës bujqësore 6000 m², me çmimin 12.000.000 lekë, ndodhur në {***} zona kadastrale {***}, pasuria nr. {***}.

Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për burimet e krijimit të ndërtimit në fazën e dytë të tri ndërtesave të qendrës rezidenciale në {}, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton:***

57. Sipas subjektit në ankim, faza e dytë e ndërtimit të tri godinave të qendrës rezidenciale në fshatin “{***}”, {***}, Tiranë, është kryer në periudhën maj - shtator 2002 dhe si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e sipërfaqes së tokës në fshatin {***}, Kukës misionit S.O.S., në vitin 1999, në shumën 6.000.000 lekë; kredi bankare në vlerën 150.000 USD, marrë nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë në gusht 2002; të ardhurat nga qiraja e tri banesave në {***} për vlerën e një viti, nga qiramarrësi Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me seli në Tiranë, në vlerën 90.000 USD, në shtator të vitit 2002; të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “{***}” ShPK; të ardhurat në shumën 740.000 USD, përfituar nga shitja e sipërfaqes së tokës në pronësi të A. P, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.02.2006.

58. Në përgjigje të pretendimeve më sipër të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton:

58.1 Për të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e sipërfaqes së tokës në fshatin {***}, Kukës, misionit “{***}”, në vitin 1999, në shumën 6.000.000 lekë, të pretenduar si burim financiar për ndërtimin e tri godinave në {***}, nga analizimi i dokumentacionit justifikues ligjor të administruar, trupit gjykues i rezulton të jetë depozituar dokument financiar, çek bankar i paguar nga Banka Italo Shqiptare ShA, më datë 12.05.1999, në shumën 1.500.000 lekë, në emër të I. P. Sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, nuk provohet pretendimi i subjektit për të ardhurat në shumën 6.000.000 lekë.

58.2 Sa i përket burimit të të ardhurave nga kredi bankare në vlerën 150.000 USD, marrë nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë në gusht 2002, pretenduar nga subjekti të jenë përdorur për ndërtimin e fazës së dytë të tri godinave objekt shqyrtimi, trupi gjykues analizoi dokumentacionin justifikues, përcjellë nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA), e cila me vërtetimin e datës 15.10.2018, konfirmon se kredia më sipër i është financuar shoqërisë “{***}” ShPK, më datë 13.08.2002, për nevoja të aktivitetit ekonomik të shoqërisë dhe jo individit A. P për të ndërtuar tri godinat në fshatin “{***}”, {***}, Tiranë, kredi e cila është shlyer tërësisht më 14.11.2005. Sa më sipër, ky pretendim nuk është i bazuar.

58.3 Lidhur me të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e tri banesave në {***}, për vlerën e një viti, nga qiramarrësi Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me seli në Tiranë, në vlerën 90.000 USD, në shtator të vitit 2002, trupit gjykues, nga analizimi i dokumentit bankar të lëshuar nga Banka Amerikane e Shqipërisë ShA, i rezulton se më datë 16.10.2002, A. P ka tërhequr nga llogaria e tij bankare nr. 40883735101 në USD, shumën e qirasë së një viti, në vlerën 89.000 USD. Nga sa më sipër, rezulton që shuma e qirasë e marrë paradhënie në tetor të vitit 2002, nuk mund të ketë shërbyer si burim financimi për ndërtimin e tri banesave në {***}, ndërkohë që subjekti pretendon se ndërtimi i tyre ka përfunduar në muajin gusht të vitit 2002, sipas përgjigjeve të pyetësorit shtesë të Komisionit apo në shtator të vitit 2002, sipas pretendimeve në ankim.

58.4 Për pretendimin e subjektit se të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “{***}” ShPK, me pronar dhe administrator të vetëm shtetasin A. P, babain e subjektit të rivlerësimit, janë përdorur si burim financiar për ndërtimin e tri godinave në {***}, pas analizimit të raportit të

shoqërisë audituese “{***}” ShPK dhe procesverbalit nr. {***}, datë 21.01.2006, të inspektorëve të DPT¹⁴ Tiranë për kontrollin e mbajtur me nr. {***}, datë 16.01.2006, përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 16.07.2018, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, trupi gjykues në Kolegj konstaton që shoqëria të mos ketë tërhequr fitim neto prej vitit të krijimit 1994 deri në vitin 2000, por ta ketë akumuluar atë, si dhe nuk i rezulton të jetë shpërndarë dividend për vitet 2002-2005, periudhë në të cilën janë krijuar pasuritë objekt shqyrtimi.

58.5 Lidhur me pretendimin e subjektit se të ardhurat në shumën 740.000 USD, përfituar nga shitja e sipërfaqes së tokës në pronësi të A. P, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.02.2006, kanë shërbyer si burim financiar për ndërtimin e godinave objekt shqyrtimi, nga analizimi i kontratës më sipër, trupi gjykues i rezulton që babai i subjektit A. P i shtet shoqërisë “{***}” ShPK truall me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në {***}, dhe impiant prodhimi betoni të montuar mbi këtë sipërfaqe. Referuar nenit 3 të kësaj kontrate, çmimi është përcaktuar në vlerën 740.000 euro, është likuiduar 60.000 euro paradhënie në muajin gusht 2005 dhe pjesa e mbetur, në vlerën 680.000 euro, paguar me transfertë në llogarinë bankare të I. P, pranë Bankës NBG Albania ShA. Nisur nga mospërputhjet e afateve kohore të shumës së përfituar nga ky transaksion juridik gusht 2005 dhe kohës së pretenduar për përfundimin e ndërtimit të tri godinave në {***} maj – shtator 2002, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e pretenduara të përfituara si më sipër nuk mund t’i kenë shërbyer A. P si burim financiar për fazën e dytë të ndërtimit.

59. Në përfundim të gjithë sa arsyetuar më sipër, bazuar në provat shkresore që u morën në shqyrtim dhe u analizuan, për këto pasuri, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se të ardhurat e pretenduara nga subjekti nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për përfundimin e ndërtimit të fazës së dytë të tri godinave në fshatin {***}, {***}, Tiranë.
60. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., datë 09.09.2016, konfirmohet fakti që investimi për këtë pasuri është kryer nga burimet financiare të subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2016, trupi gjykues konstaton se trashëgimtarët e tjerë ligjorë Xh. P, S. P dhe I. P deklarojnë: [...] heqim dorë dhe kërkojmë që procedurat ligjore për legalizimin e objektit të lartpërmendur të vazhdojnë në emrin e djalit dhe vëllait tonë Fehmi Petku, pasi nuk kemi dhënë asnjë kontribut financiar në ndërtimin e këtij objekti, duke deklaruar se as sot dhe as në të ardhmen nuk do të kemi asnjë pretendim pronësie mbi pronën e mësipërme në proces legalizimi. Kjo deklaratë redaktohet për ta depozituar pranë Zyrës së ALUIZNI-t Tiranë, për të ndjekur procedurat e legalizimit të këtij objekti në emrin e Fehmi Petkut, si trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit A. S. P. Nisur nga përmbajtja e deklaratës noteriale, trupi gjykues, ndryshe nga arsyetimi i përdorur nga Komisioni, çmon se kjo deklaratë është përpiluar për t’i shërbyer ndjekjes së procedurave të legalizimit të ndërtesës nga vetë subjekti i rivlerësimit (aktualisht në pronësi të tij, me nr. pasurie {***}) dhe jo si ka konkluduar Komisioni në vendimin e tij.

Në përfundim, për shtëpinë e banimit të përbërë nga dy kate banimi dhe bodrum, me sipërfaqe kati 130 m², e ndodhur në fshatin “{*}”, {***}, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.**

¹⁴ DPT, Tiranë = akronim për Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë

61. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet e mëposhtme.
- i. Deklarata “vetting” e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI.
 - ii. Deklaratat e interesave privatë periodikë të viteve 2015 dhe 2016.
 - iii. Dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.06.2015.
 - iv. Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep. dhe {***} kol. datë 14.08.1996, shitës K. B, blerës A. P.
 - v. Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 14.08.1996, shitës N. B., blerës A. P.
 - vi. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 30.07.2018.
 - vii. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2016.
 - viii. Shkresa nr. {***} prot., datë 13.02.2018, e ALUIZNI-t, Drejtoria Tirana Jug.
 - ix. Leja e legalizimit nr. {***}, datë 20.10.2016.
 - x. Shkresa nr. {***} prot., datë 15.02.2018, e ZVRPP Tiranë.
 - xi. Vendimi nr. {***}, datë 17.06.2002, i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.
 - xii. Formulari i vetëdeklarimit për legalizim nr. {***} (nr. aplikimi {***}), datë 23.03.2005.
 - xiii. Kontratë huaje, datë 27.04.1996, mes S. P dhe kompanisë “{***}” dhe aktmarrëveshje e datës 28.04.1996.
 - xiv. Shkresë nr. {***} prot., datë 05.11.2018, e Administratorit të Shoqërive Huamarrëse në Administrim.
 - xv. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.07.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.
 - xvi. Dokumente të tjera të depozituara nga subjekti.

Për pasurinë ndërtim informal mbi truallin me sipërfaqe 16.000 m², të ndodhur në fshatin {}, {***}, Tiranë***

62. Komisioni për këtë pasuri ka arritur në përfundimet e mëposhtme.
- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje në deklaratën “vetting” dhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, të këtij ndërtimi.
 - ii. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.
 - iii. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.
63. Pasurinë truall me sipërfaqe 16.000 m², të ndodhur në fshatin {***}, {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësim vetting 2017, si dhe në deklaratën e interesave privatë të viteve 2015 dhe 2016, të fituar me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.06.2015, blerë si më poshtë.
- a) Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.1996, me shitës F. Sh., blerës A. P, për sipërfaqen 4500 m², çmimi 500 lekë/m², në vlerën 2.250.000 lekë. Pjesa takuese 1/4.
 - b) Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr {***} kol., datë 19.07.1996, shitës O. B., blerës A. P, për sipërfaqen 250 m², çmimi 500 lekë/m², në vlerën 125.000 lekë.
 - c) Aneks kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.08.1996, shitës O. B., blerës A. P, për sipërfaqen 200 m², çmimi 500 lekë/m², në vlerën 100.000 lekë. Pjesa takuese 1/4.
 - ç) kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.1996, shitës F. Sh., blerës A. P, për sipërfaqen 632 m², çmimi 500 lekë/m², në vlerën 316.000 lekë. Pjesa takuese 1/4.

- d) Për sipërfaqen prej afërsisht 10.000 m², nga totali 16.000 m², subjekti deklaroi se nuk disponon dokument, pasi nuk kam mundur të gjej deri në këto momente aktet e shitblerjes së saj, por sqaron se që nga gushti 1996, shkurti 1997 dhe deri në nëntor 2014, kjo sipërfaqe është poseduar nga trashëgimlënësi A. S. P dhe nga nëntori 2014 e deri më sot posedohet nga trashëgimtarët e tij, Fehmi, S., I. dhe Xh. P. Edhe kjo sipërfaqe është blerë në vitin 1996-1997 shtetasit M. Xh., me çmim 125 lekë/m², në vlerën totale afërsisht 1.250.000 lekë. Subjekti deklaroi se e gjithë sipërfaqja e mësipërme është një parcelë e vetme, e pandarë dhe ndodhet në fshatin {***}, Komuna {***}, Tiranë dhe është e paregjistruar në zyrat e ZRPP në emër të trashëgimlënësit A. P, për shkak të mungesës së dokumentacionit të duhur ligjor nga ana e shitësit.
64. Mbi truallin më sipër, rezulton të ketë ndërtim informal, ndërtuar nga A. P në vitin 1996, si vetëdeklaroi në Deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje nr. {***}, datë 11.12.2014, konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 13.09.2018, përcjellë Komisionit nga Drejtoria e ALUIZNI-t, Tirana Rurale.
65. Sipas subjektit, nisur nga fakti që ndarja e pjesëve është bërë me mirëkuptim familjar përpara se të çelej trashëgimia ligjore, sipërfaqja e tokës në {***} mbi të cilën ndodhet ndërtimi informal, i takon vëllait të tij S. P. Për qëndrimin kundër konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje në deklaratën “vetting” dhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, të këtij ndërtimi, subjekti pretendon të mos ta ketë deklaruar as në deklaratat periodike dhe as në deklaratën vetting, pasi nuk ka pasur asnjë të drejtë pronësie mbi ndërtimin informal. Subjekti arsyeton se personi i vetëm i interesuar për këtë ndërtim, që ka ndjekur edhe procedurat e legalizimit të tij, ka qenë S. P, fakt që bëhet edhe më i besueshëm nga analizimi i praktikës së legalizimit të administruar nga Komisioni, ku në formularin e deklaramit ndodhet numri i telefonit të vëllait, S. P. Subjekti mbështet pretendimin më sipër edhe me faktin që sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2016, trashëgimtarët e tjerë ligjorë të A. P, heqin dorë nga ky objekt dhe kërkojnë që procedurat ligjore për legalizimin e tij, të ndodhur në fshatin {***}, Komuna {***}, të vazhdojnë në emrin e S. P.
66. Lidhur me pretendimin më sipër, u analizua shkresa nr. {***} prot., datë 13.09.2018, e Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Rurale, referuar të cilës praktika e legalizimit për objektin informal në shqyrtim, bazuar në dëshminë e trashëgimisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.06.2015, ka kaluar nga A. S. P, në emër të trashëgimtarëve Xh. Xh. P., S. A. P, I. A. P dhe Fehmi A. P, në emër të të cilëve është lëshuar leja e legalizimit nr. {***}, datë 16.03.2018, për objektin e kombinuar 1 kat dhe 2 kat, me nr. pasurie {***}, sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe totale për banim 105 m² dhe për aktivitet 193,5 m², ndodhur në z.k. {***}.
67. Nga analizimi i dokumentacionit ligjor të sipërcituar, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton që edhe pse trashëgimtarët ligjorë kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 19.09.2016, me anë të së cilës Xh., I. dhe Fehmi Petku kanë hequr dorë nga procedurat ligjore për legalizimin e objektit informal të ndodhur në fshatin {***}, Komuna {***}, duke kërkuar vazhdimin e tyre në emër të/nga S. P, kjo deklaratë noteriale nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike, pasi procedurat e legalizimit kanë vijuar përsëri në emër të/nga të gjithë trashëgimtarët ligjorë të z. A. P, përfshirë dhe subjektin e rivlerësimit Fehmi Petku, dhe leja e legalizimit është emetuar edhe në emër të subjektit, shpjeguar në paragrafin më sipër.

Nga gjithë sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues gjen të pabazuar pretendimin e subjektit lidhur me këtë pasuri dhe arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë ndërtimin informal mbi truallin në {***}, Tiranë, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në deklaratat e interesave privatë të viteve 2015 dhe 2016.

Në përfundim, për pasurinë ndërtim informal mbi truallin me sipërfaqe 16.000 m², të ndodhur në {}, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84/2016.***

68. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet si më poshtë.
- i. Deklarata “vetting” e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI.
 - ii. Deklaratat e interesave privatë periodikë të viteve 2015 dhe 2016.
 - iii. Dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.06.2015.
 - iv. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 06.01.1997, në emër të M. Xh..
 - v. Deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje nr. {***}, datë 11.12.2014.
 - vi. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2016.
 - vii. Shkresë nr. {***} prot., datë 13.09.2018, e Drejtorisë së ALUIZNI-t, Rurale, dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
 - viii. Leje e legalizimit, e lëshuar nga ALUIZNI, në përfundim të procedurave të legalizimit nr. {***}, datë 16.03.2018.

Analiza e treguesve financiarë, pasuri, detyrime, të ardhura, shpenzime të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016

69. Komisioni, për analizën financiare të kryer për periudhën 2003 – 2016, ka arritur në përfundimet e mëposhtme.
- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe shpenzimet e deklaruara e të llogaritura në analizë, sipas nenit D të paragrafit 3 të Aneksit të Kushtetutës.
 - ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
70. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përllogaritjet e Komisionit sa u përket shpenzimeve të arredimit dhe metodës së përdorur për përllogaritjen e tyre. Sipas subjektit në ankim, shpenzimet e arredimit janë ndarë në vlera të barabarta për të gjithë periudhën 2003 – 2016, në vlerën 178571 lekë për çdo vit. Subjekti pretendon se në vendimin përfundimtar të Komisionit, ndryshe nga raporti paraprak, në tabelat e viteve nuk gjejnë pasqyrim të gjitha vitet objekt verifikimi, si dhe në tabelat e pasqyruara në vendim, vlera e arredimit ndër vite është më e ulët se në raportin paraprak, pa u dhënë sqarim përse kanë ndryshuar këto vlera.
- Për pretendimin më sipër, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në analizën financiare të kaluar si barrë prove subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, ka përllogaritur shpenzimet e kryera nga subjekti për arredim në mënyrë përpjesëtimore, të barabartë, për çdo vit të periudhës 2003-2016 të analizuar, në vlerën 178571 lekë, bazuar në sa vetëdeklaroi subjekti në përgjigje të pyetjes nr. 11 të pyetësorit standard të Komisionit se vlera e përafërt e arredimit mund të jetë

2.500.000 lekë të rinj, vlerë e cila përfshin çdo arredim të mëparshëm, si dhe rinovimin e filluar në qershor të 2017 dhe të papërfunduar akoma. [...] gjithashtu në pesë vitet e fundit, kam instaluar tre kondicionerë.

Në analizën financiare të paraqitur në vendim, Komisioni ka konsideruar sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit me prapësimet për analizën financiare, përcjellë me rezultatet e hetimit për të cilat ka paraqitur *aktekspertim mbi raportin financiar*, përgatitur nga eksperti kontabël I. D. (studio “{***}”), sipas të cilit *totali i arredimit në vlerën 2.500.000 lekë përfshin rinovimin e bërë në qershor – dhjetor 2017, në një vlerë të deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë të vitit 2017, prej 13.000 eurosh*, duke zbritur kështu nga shpenzimet totale për arredim prej 2.500.000 lekësh shumën 13.000 euro, shpenzuar për arredim në vitin 2017.

Në ndryshim nga Komisioni, me konsideratë kundërshtimet e subjektit për vlerën e arredimit dhe metodikën e ndjekur nga Komisioni për këto përllogaritje, në analizën financiare të kryer në Kolegj, kostoja për arredim/mobilim u përllogarit duke zbritur nga kostoja totale për arredim/mobilim, deklaruar nga subjekti në vlerën 2.500.000 lekë, shumën 13.000 euro, shpenzuar për këtë qëllim në vitin 2017, si deklaruar në deklaratën e interesave privatë të këtij viti. Në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, diferenca e rezultuar nga përllogaritjet më sipër është ndarë në mënyrë përpjesëtimore për katër vitet 2013-2016, në vlerën 724.542 lekë.

71. *Subjekti i rivlerësimit kundërshton përllogaritjen e shpenzimeve jetike në analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke vendosur vlera më të larta në disa vite, për të cilat nuk jepen sqarime në vendimin e tij.*

Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni për përllogaritjen e shpenzimeve jetike në analizën financiare përcjellë subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ, është bazuar në ndarjen përpjesëtimore për 14 vite të periudhës së rivlerësimit 2003-2016 të totalit të shpenzimeve minimale për konsum familjar, përllogaritur nga ILDKPKI-ja, në vlerën 13.400.000 lekë, ndërsa pas prapësimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni ka rivlerësuar shpenzimet jetike, duke i përllogaritur ato sipas ILDKPKI, INSTAT, e për këtë arsye vlerat e shpenzimeve jetike në analizën financiare të paraqitur në vendim, janë të ndryshme nga ato të analizës së rezultateve të hetimit administrativ.

Me konsideratë pretendimet e subjektit, në analizën financiare të kryer në Kolegj, shpenzimet për konsum familjar apo jetike janë përllogaritur sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të INSTAT-it, përcjellë Kolegjit nga ILDKPKI-ja.

72. *Subjekti i rivlerësimit e konsideron të padrejtë përllogaritjen në analizën financiare për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të kryer nga Komisioni, të vlerës së qirasë financiare (leasing) paguar në Tirana Leasing ShA fillimisht dhe Raiffeisen Leasing ShA më pas, në shumat 1.057.406 lekë, 764.267 lekë, 1.005.137 lekë dhe 868.631 lekë përkatësisht, pra në total 3.694.441 lekë, shumë e cila sipas subjektit duhej llogaritur 50% e vlerës më sipër, për faktin që detyrimet në masën 50% (për njërin nga automjetet), në vlerën 1.847.720 lekë, janë përballuar nga shtetasi A. E.*

Për pretendimin më sipër, trupi gjykues analizoi deklaratat e interesave privatë periodikë dhe deklaratën *vetting*, nga ku rezultoi që personi i lidhur, B. P., të ketë deklaruar për herë të parë në deklaratën e vitit 2013 blerjen e dy automjeteve të markës Citroen, tip Berlingo, në vlerën totale 26.000 euro, 13.000 euro secila, nëpërmjet kontratës së qirasë financiare nr. {***} rep., {***} kol., datë 16.04.2013, me Tirana Leasing ShA, transferuar më pas në Raiffeisen Leasing ShA, me afat maturimi më 06.04.2018 dhe interes 8,5% në vit. Në rubrikën shpenzime të deklarueshme, personi i lidhur deklaroi se *një nga mjetet, me targë {***}, pavarësisht kontratës*

me bankën në emër të deklaruesit, përdoret për nevojat e tij nga punonjësi A. E., i punësuar si kuzhinier te “{***}”, i cili paguan çdo detyrim financiar lidhur me këtë mjet. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaron “Dorëzanës në kontratën e “Qirasë Financiare” (Leasing) me numër 2179, datë 11.04.2013, të lidhur midis Tirana Leasing ShA (qiradhënës) dhe B. P. (qiramarrës)”. Personi i lidhur B. P. deklaron sa më sipër në deklaratat periodike të viteve në vijim dhe në deklaratën e pasurisë vetting.

73. Për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ cituar më lart, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës në Komision, deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2019, të shtetasit A. E., i cili deklaron se për periudhën mars 2013 - mars 2014 ka punuar si kuzhinier në bar-restorant “{***}”, ndodhur në fshatin {***}, e për nevoja të punës me orare të ndryshme ka vlerësuar të domosdoshëm pasjen e një mjeti transporti, në mungesë të transportit publik. Në pamundësi për të blerë vetë një mjet me qira financiare (leasing), e ka realizuar këtë nëpërmjet administratorit të subjektit tregtar “{***}”, B. P.. Sipas deklarimeve të z. A. E. në këtë deklaratë, *të gjitha këstet mujore, principal dhe interesa, sipas kontratës së qirasë financiare për mjetin me targë {***}, janë paguar prej tij deri në shlyerjen e plotë të vlerës së këtij mjeti në muajin prill 2018, mjet i cili që nga momenti i marrjes në prill të vitit 2013 dhe aktualisht, është në përdorimin e tij të pandërprerë.*
74. Shoqëria Raiffeisen Leasing ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.02.2018, dhe shkresën nr. {***} prot., datë 25.07.2018, i përcjell Komisionit kontratë qiraje financiare (leasing) nr. {***}, nënshkruar mes “Tirana Leasing” ShA, në cilësinë e qiradhënësit, personit fizik “B. P.”, regjistruar me NIPT {***} dhe emër tregtar “{***}”, në cilësinë e qiramarrësit, B. P. dhe Fehmi Petku, si dorëzanës, si dhe faturat për pagimin e detyrimeve për kontratën leasing më sipër. Në pikën 26 të kontratës së qirasë financiare, parashikohet: *Dhënia e sendit me nënqira te të tretët dhe në përgjithësi dhënia në përdorim e sendit te të tretët apo kalimi te të tretët i të drejtave dhe detyrimeve të Qiramarrësit, që rrjedhin nga kjo kontratë, është e ndaluar dhe mund të bëhet vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të Qiradhënësit.* Duke qenë se nga dokumentacioni i administruar në dosje nuk rezulton që qiradhënësi, “Tirana Leasing” ShA, të ketë dhënë pëlqimin paraprak për përdorimin e automjetit me targë {***} apo kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të kësaj kontrate tek A. E., trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2013, nuk mund të merret në konsideratë. Përveç sa sipër, referuar dokumentacionit financiar të përcjellë nga Raiffeisen Leasing ShA, në depozitimet e kryera për likuidimin e detyrimeve të qirasë financiare, rezulton në përshtetshmëri të shkruhet shprehimisht: *për {***} (B. P.), makinë me targë {***} depoziton A.E apo “{***}” këst leasing për targë {***}, depoziton A. E. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni ka përllogaritur në analizën financiare të kryer të gjitha shpenzimet e bëra për likuidimin e detyrimeve të kësaj qiraje në emër të personit të lidhur B. P. dhe vetë subjektit. Edhe nëse konsiderojmë pretendimin e subjektit lidhur me kryerjen e pagesës së këstit të qirasë financiare për njërin automjet nga A. E., nga analiza e kryer në Kolegj rezultoi se të ardhurat nga burime financiare të ligjshme, pagat e tij, sipas shkresës së DRT, Tiranë, datë 22.02.2018, nuk janë të mjaftueshme për likuidimin e këstit mujor prej 240 eurosh ose 33.100 lekësh.*
75. Për sa i përket pretendimit të subjektit se Komisioni nuk ka pasqyruar në analizën financiare në vendim të ardhurat e subjektit nga Federata Shqiptare e Futbollit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit deklaron: *të ardhura nga angazhimi në Federatën Shqiptare të Futbollit Tiranë, si kryetar i Komisionit të Disiplinës së Apelit, nga*

shtator 2003 – qershor 2006 [...] shuma 555.000 lekë. Në vërtetimin me nr. {***} prot., të datës 27.01.2017, të lëshuar nga Federata Shqiptare e Futbollit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting përcaktohen të ardhurat e Fehmi Petkut për periudhën shtator 2003 – qershor 2006, në vlerën 555.000 lekë.

Nga analizimi i deklaratave periodike, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura si kryetar i Komisionit të Disiplinës të Apelit pranë Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF) në vitin 2003, por nuk deklaroi vlerën e këtyre të ardhurave, në vitin 2005 deklaroi të ardhura në vlerën 200.000 lekë, ndërsa në vitin 2006 deklaroi të ardhura në vlerën 100.000 lekë. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2018, ka kërkuar të dhëna nga FShF-ja lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga subjekti çdo vit, por për këtë kërkesë nuk rezultoi të ketë marrë përgjigje. Sa më sipër, në analizën financiare të kryer në Kolegj janë marrë në konsideratë të ardhurat nga angazhimi në FShF, të cilat janë deklaruar në deklaratat e interesave privatë të viteve 2005 dhe 2006.

76. *Subjekti ngre pretendimin se Komisioni nuk ka përlogaritur te të ardhurat pagat e personit të lidhur, djalit, B. P. për vitin 2013, si i vetëpunësuar, në masën 204.900 lekë. Me konsideratë pretendimin e subjektit, në analizën financiare të kryer në Kolegj, janë marrë në konsideratë të ardhurat nga paga neto e djalit B. P, të përfituara nga aktiviteti ekonomik si person fizik, me NIPT {***}, për periudhën shkurt 2013 – mars 2014, në vlerën totale 174.409 lekë, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.02.2019.*
77. *Lidhur me pretendimin se nga përlogaritja e përgjithshme, sipas vendimit përfundimtar të Komisionit, rezultoi se totali i përgjithshëm i mosrakovit, për gjithë periudhën objekt rivlerësimi, 2003-2016, në total është vlerësuar në shumën 960.380 lekë, trupi gjykues arsyetoi se kjo balancë tregon mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të realizuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për vitin 2016 dhe jo si pretendon subjekti. Shuma totale e mungesës së burimeve financiare të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të, përlogaritur nga Komisioni sipas analizës financiare të paraqitur, rezultoi në vlerën 5.317.657 lekë, vlerë vetëm e viteve që kanë rezultuar me diferencë negative, pra me mungesë të burimeve financiare nga të ardhura të ligjshme.*
Mungesa e të dhënave financiare të disa viteve në tabelën e analizës financiare përfundimtare të Komisionit, paraqitur në vendim, konkretisht për vitet 2003, 2004, 2005, 2008 dhe 2016 të konstatuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk ka të bëjë me gabim në përlogaritje apo material të Komisionit, por me faktin që rezultatet e analizës financiare të kryer për vitet më sipër, kanë treguar mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të për të krijuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në secilin vit më sipër, përkatësisht.
78. *Sa i përket kërkesës së subjektit të rivlerësimit në ankim se treguesit financiarë për periudhën 2003 – 2016, të paraqitur në vendimin përfundimtar të Komisionit, të analizohen edhe një herë nga ekspertë përkatës të licencuar, me qëllim arritjen e përfundimeve sa më objektive, trupi gjykues vlerëson se Komisioni dhe Kolegji në shqyrtimin e çështjeve asistohen nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, sipas përcaktimeve të neneve 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit të pasurisë nuk është një proces vlerësimi vetëm financiar, por një balancë mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Trupi gjykues vlerëson se Kushtetuta dhe*

ligji e kanë pajisur Komisionin dhe Kolegjin me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një analizë të saktë dhe shteruese të provave të administruara.

79. Për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, për të justifikuar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës 2003 – 2016, bazuar në përfundimet e arritura nga trupi gjykues pas analizimit dhe vlerësimit ligjor të shkaqeve të ankimit, u krye analiza financiare në Kolegj rezultatet e së cilës konfirmuan vlerën negative të përlogaritur nga Komisioni. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
80. Arsyetimi i mësipërm u bazua në aktet e mëposhtme.
- i. *Deklarata e pasurisë (vetting) 2017, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur.*
 - ii. *Deklarata e pasurisë për herë të parë, në vitin 2003.*
 - iii. *Deklaratat e interesave privatë për vitet 2004 - 2016.*
 - iv. *Akt ekspertimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.*
 - v. *Shkresa nr. {***}prot., datë 04.03.2019, e ILDKPKI-së.*
 - vi. *Dokumentacioni i përcjellë nga bankat e nivelit të dytë.*
 - vii. *Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.*

III/3. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e kontrollit të figurës

81. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kontrollin e figurës, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. *Fehmi Petku*, është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar, për shkak të mundësisë për vënien e tij nën presion nga strukturat kriminale për favorizim apo për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, në papajtueshmëri të plotë me detyrën.
82. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstaton se:
- 82.1** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, dërgon në Komision raportin e Grupit të Punës mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit: *formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; për subjektin nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.* Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit. Në këtë raport theksohet se është përpiluar pa përgjigjen e një prej 3 autoriteteve verifikuese, Shërbimit Informativ të Shtetit.
- 82.2** DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2018, dërgon raportin vijues të Grupit të Punës mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit. Në këtë raport, të deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. {***} prot., datë 25.04.2018, grupi i punës nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese *ndryshon konstatimin fillestar, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit.*

Nga analizimi i raportit vijues të Grupit të Punës, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2018, të DSIK-së, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky raport nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për t'u bazuar, së pari, siç përmendet në përmbajtjen e raportit, informacioni që disponohet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, i përket një periudhe të hershme dhe të largët nga periudha e rivlerësimit, në këtë raport nuk janë identifikuar qoftë me iniciale personat e përfshirë në krimin e organizuar, me të cilët subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme në kuptim të pikave 6, 8 dhe 15 të nenit 3 dhe pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, konstatohet se nuk është bërë asnjë veprim i mëtejshëm nga Komisioni për të krijuar bindjen që subjekti i rivlerësimit është në kushtet e papërshtatshmërisë për të kryer detyrën. Në lidhje me personin e lidhur, djalin e subjektit, B. P, nga aktet e administruara në Komision, nuk rezultuan të dhëna që është i dënuar apo që ndaj tij të ketë filluar një procedim penal për vepra nga ato që referon neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 e që do e klasifikonin atë si një person të përfshirë në krimin e organizuar. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se të dhënat e raportit të Grupit të Punës, përcjellë nga DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2018, si dhe rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni, janë të paplota. Të dhënat e përdorura në vendimin e Komisionit nuk i janë bërë prezent subjektit të rivlerësimit, duke mos i dhënë atij mundësinë të ezaurojë një mbrojtje efektive në përputhje me standardet e një procesi të rregullt ligjor e, për këto arsye, ato nuk mund të konsiderohen nga Kolegji si të afta që të krijojnë bindjen për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e detyrës apo të jenë rrethana të vlerësueshme në lidhje me cenimin e besimit të publikut te drejtësia, në përputhje me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III/4. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

83. Komisioni, në vendimin nr. 136, datë 09.04.2019¹⁵, ka konkluduar se *subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, duke ushtruar funksionin e tij në kushtet e një konflikti të hapur interesi, që rezulton i njohur edhe nga prokurori i asaj çështjeje, ka cenuar rëndë etikën e gjyqtarit. Këtë konkluzion të tij, mbi etikën e gjyqtarit, Komisioni e përfshin dhe në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve, duke zbatuar si rrjedhojë nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*
84. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i dokumentacionit të dosjes lidhur me këtë çështje, konstaton se:
- 84.1 Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.04.1999, dërgon në Gjykatën e Rrethit Tiranë për gjykim *dosjen penale nr. {***}, në ngarkim të të pandehurve V. A., Dh. Gj., A. A., E. B. dhe A. M., të akuzuar për veprën penale të vjedhjes me anë të mashtrimit të kryer në bashkëpunim dhe kryerje të krimeve nga organizata kriminale, vepër kjo që parashikohet nga neni 143-25 (68857 herë) – 334/1 të Kodit Penal.*
- 84.2 Kryesues i çështjes caktohet z. Fehmi Petku, i cili më datë 17.05.1999, pas shqyrtimit të fashikullit të gjykimit, cakton seancën gjyqësore më datë 28.05.1999, ora 10:00. Në seancën e datës 16.06.1999, prokurori i çështjes, pas shpalljes së trupit gjykues, ka kërkuar përjashtimin e kryesuesit të trupit gjykues Fehmi Petku, për arsye se vazhdimi i gjykimit nga ana e tij përbën shkelje të nenit 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, pasi ka interes në këtë procedim penal, konkretisht vëllai i tij është dëshmitar dhe ka depozituar para në firmën “{***}”.

¹⁵ Shih paragrafin 133 (faqe 29) të vendimit të Komisionit.

84.3 Subjekti Fehmi Petku e konsideron kërkesën për përjashtim të pabazuar në ligj: [...] Sipas nenit 17/1/a të K.Pr.Penale, shkak për heqjen dorë nga ana ime nga gjykimi i kësaj çështjeje, do të ishte një marrëdhënie direkte e imja, e bashkëshortes sime ose e fëmijëve të mi, rrethanë që nuk ekziston në rastin konkret.

Në këto kushte, meqenëse rasti i një marrëdhënieje të tillë është i pasqyruar në mënyrë taksative në nenin 17/1/a të K.Pr.Penale dhe unë si gjyqtar nuk jam në një marrëdhënie të tillë, e konsideroj të padrejtë dhe të pabazuar në ligj kërkesën e paraqitur nga prokurori i çështjes. Me konsideratën se argumentet e dhëna nga ana ime do të jenë bindëse për gjykatën, jemi në pritje të vendimit tuaj.

84.4 Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, të datës 30.07.1999, vendos pranimin e kërkesës të bërë nga organi i prokurorisë, duke përjashtuar Fehmi Petkun nga gjykimi i çështjes penale me nr. {***} akti, datë 27.04.1999, në ngarkim të të pandehurve V. A. etj.

84.5 Kundër këtij vendimi ka depozituar rekurs më datë 2.8.1999, ankuesi V. A., duke e konsideruar në kundërshtim flagrant me ligjin, presion të hapur që ushtron organi i akuzës ndaj gjyqtarëve për të mbuluar shkeljet e rënda që ka lejuar gjatë hetimit, në dëm të interesave të tij dhe, në bazë të nenit 22/4 të K.Pr.P, kërkon prishjen e tij nga Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 24.08.1999, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur dhe lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 30.07.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë”, me arsyetimin *se rekursi nuk ka respektuar detyrimet procedurale që parashikon neni 435/2 i K.Pr.Penale. Në bazë të këtij neni, rekursi duhet të nënshkruhet nga mbrojtja. Mungesa e një forme të tillë sjell si pasojë ligjore mospranimin e rekursit.* Më datë 25.08.1999, rekursi është depozituar nga përfaqësuesja ligjore e V. A., por më datë 27.9.1999 u hoq dorë nga rekursi i përpiluar, në bazë të nenit 435/2 të K.Pr.Penale, duke kërkuar që dosja t’i kthehet administrativisht Gjykatës së Rrethit Tiranë sepse rekursi është bërë gabimisht, kur çështja është shqyrtuar njëherë nga Kolegji i Gjykatës së Lartë.

85. Pretendimi i subjektit se, kur shtetasi V. A. ka ardhur për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ishte më subjekt juridik, pasi shoqëria “{***}” ShPK në pronësi të tij, përfaqësohej nga administratorët e shoqërisë dhe, për rrjedhojë, të gjitha marrëdhëniet e familjarëve të subjektit ishin me administratorët e mësipërm dhe jo me shtetasin V. A., trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron, pasi kontrata e shitblerjes së shtëpisë së ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, banesa aktuale e subjektit, dhe kontrata e huas janë nënshkruar pikërisht me z. V. A. dhe jo me administratorët e shoqërisë “{***}” në administrim. Nisur nga fakti që të gjitha pasuritë e tjera të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit kanë si burim krijimi shitjen e banesës në rr. “{***}”, në vlerën 520000 USD, z. V. A, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të hiqte dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje që pas caktimit të tij kryesues i trupit gjykues.

86. Pretendimet e subjektit se nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, as në shqyrtimin gjyqësor dhe as në vendimmarrjen përfundimtare në atë gjykim, nuk e përjashton subjektin nga ndodhja në kushtet e shkeljes së rëndë së etikës së gjyqtarit, pasi, siç rezulton nga praktika gjyqësore, nëse nuk do të ishte paraqitur kërkesa për përjashtim nga ana e prokurorit, subjekti do të vijonte të shqyrtonte çështjen penale me të pandehur V. A, fakt i provuar dhe më pas me kërkesat e tij për mospërjashtim. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.

87. **Trupi gjykues i Kolegjit, duke vlerësuar se në çdo rast që një gjyqtar ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, kjo sjell cenim të besimit të publikut te drejtësia, për rastin konkret duke konsideruar faktet e çështjes objekt shqyrtimi, si gjykimi i saj më pas nga një trup gjykues i paanshëm, ku nuk janë cenuar të drejtat dhe interesat ligjorë të palëve të interesuara, fakti që shkelja e konstatuar është kryer në vitin 1999, jashtë periudhës së rivlerësimit të parashikuar nga neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe fakti që mbetet rast i vetëm, i papërsëritur nga subjekti në vijim të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, si dhe parë në harmoni me vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit lidhur me kontrollin e figurës, arrin në përfundimin se rrethanat e analizuara më lart, qoftë konflikti i interesit apo edhe të dhënat e padebatuara e të pashoqëruara me elemente provues të çfarëdo natyre tjetër, të përcjella prej DSIK-së në raportin e saj, nuk janë të tilla që të bindin trupin gjykues se subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.**
88. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit në lidhje me ankimin, dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në këtë çështje, arrin në përfundimin se:
- Për pasurinë truall me sipërfaqe 372 m² dhe banesë mbi këtë truall, e përbërë nga tri kate, bodrum dhe papafingo, e ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
- Për pasurinë shtëpi banimi, e përbërë nga dy kate banimi dhe bodrum, me sipërfaqe kati 130 m², e ndodhur në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.*
- Për pasurinë ndërtim informal mbi truallin me sipërfaqe 16.000 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë në deklaratën e pasurisë vetting 2017, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84/2016.*
- Për analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
89. Trupi gjykues, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 136, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Fehmi Petku.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 16.09.2020.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, jam dakord me vendimin nr. 22, datë 16.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), për lënien në fuqi të vendimit nr. 136, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Fehmi Petku.

Unë nuk jam dakord me mendimin e shumicës për sa më poshtë.

I. Për pasurinë *truall* me sipërfaqe 372 m² dhe *banesë* mbi këtë *truall*, e përbërë nga tri kate, bodrum, papafingo, ndodhur në rrugën “{*}”, nr. {***}, Tiranë.**

2. Nga përmbajtja e akteve shkresore të administruara dhe analizuara në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, ka rezultuar e provuar se kjo pasuri është fituar me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 09.09.1960, sipas vendimit nr. {***}, datë 24.08.1960, Komiteti Ekzekutiv i Qytetit Tiranë i shet A. P. parcelën e tokës me nr. {***}, me sipërfaqe 372 m², në vlerën 7440 lekë. Nëpërmjet lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 18.3.1961, të Komitetit Ekzekutiv të Qytetit të Tiranës vendoset ndërtimi i objektit shtëpi banimi me 1 kat. Sipas subjektit të rivlerësimit, në vitin 1967 familja Petku internohet në fshatin {***}, Berat e më pas në vitin 1974 zhvendoset në fshatin {***}, Kukës. Në prill të vitit 1991, familja Petku fiton të drejtën për t’u rikthyer përsëri në banesën e ndërtuar në vitin 1961 në Tiranë, në adresën e mësipërme.
3. Kjo banesë njëkatëshe, me sipërfaqe 80 m², është shembur sipas deklarimeve të vetë subjektit në vitet 1993-1994 dhe mbi truallin e saj është ndërtuar objekt me tri kate, bodrum dhe papafingo, në vitet 1994-1995, siç përcaktohet dhe në vendimin nr. {***}, datë 29.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me të cilin është njohur pronësia e kësaj shtëpie banimi, dhe regjistruar në ZRPP Tiranë me nr. regjistri {***}, nr. rendor {***}, Tiranë, më datë 04.03.1996.
4. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësim (*vetting*), ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri si pasuri në përdorim prej vitit 2003 deri në vitin 2015, vit në të cilin e deklaroi për herë të parë të fituar si trashëgimtar ligjor i babait të tij, A.S.P.
5. Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku ka deklaruar të ketë jetuar me familjen e tij, në banesën në rr. “{***}”, Tiranë, prej ndërtimit të saj në vitin 1995, pa shprehur, deri aktualisht. Sa më sipër, evidentohet nga deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë të viteve 2003 - 2014, ku faktikisht në rubrikën “*adresë e plotë e banimit*”, deklaroi adresën e kësaj banese, pa e deklaruar këtë pasuri në përdorim.
6. Nisur nga ky fakt, çmoj se subjekti i rivlerësimit nuk përjashtohet nga përgjegjësia e parashikuar si detyrim kushtetues, përcaktuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, ku konkretisht citohet: *nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën*, si dhe detyrimi ligjor parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Nisur nga kërkesat për deklarin në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, subjekti i rivlerësimit duhet të

kishte deklaruar jo vetëm adresën e banimit, por edhe marrëdhënien me pasurinë objekt shqyrtimi.

7. Bazuar në sa sipër, jam dakord me vendimin e shumicës për sa i përket mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, por për më tepër e konsideroj mosdeklarimin e saj fshehje të pasurisë në përdorim, parashikuar në nenin 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84/2016.

II. Për pasurinë ndërtim informal, mbi truallin me sipërfaqe 16.000 m², të ndodhur në fshatin {*}, Vaqarr, Tiranë**

8. Për pasurinë e mësipërme, shumica e anëtarëve të trupit gjykues kanë vendosur *se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë në deklaratën e pasurisë për rivlerësim (vetting) 2017, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84/2016.*
9. Në nenin 4, germa "a" e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht se *në momentin e plotësimit të deklaratës së interesave privatë periodikë vjetorë, subjektet e rivlerësimit duhet të përshkruajnë hollësisht ndryshimet (shtesat dhe pakësimet) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që disponojnë, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që kanë shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotërojnë të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.*
10. Jam dakord me vendimin e shumicës, por bazuar në sa sipër, si dhe nisur nga analizimi i deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë 2015, 2016 dhe i deklaratës së pasurisë për rivlerësim (vetting), vlerësoj se ndodhemi në kushtet e fshehjes së kësaj pasurie si në deklaratën vetting (siç ka vendosur shumica), ashtu edhe në deklaratat periodike.

III. Lidhur me konfliktin e interesit dhe kontrollin e figurës

11. Shumica e trupit gjykues të Kolegjit ka vlerësuar se *në çdo rast që një gjyqtar ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, kjo sjell cenim të besimit të publikut të drejtësisë, për rastin konkret duke konsideruar faktet e çështjes objekt shqyrtimi, si gjykimi i saj më pas nga një trup gjykues i paanshëm, ku nuk janë cenuar të drejtat dhe interesat ligjorë të palëve të interesuara, fakti që shkelja e konstatuar është kryer në vitin 1999, jashtë periudhës së rivlerësimit të parashikuar nga neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe fakti që mbetet rast i vetëm, i papërsëritur nga subjekti në vijim të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, si dhe parë në harmoni me vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit lidhur me kontrollin e figurës, arrin në përfundimin se rrethanat e analizuarra më lart, qoftë konflikti i interesit apo edhe të dhënat e padebatuara e të pashoqëruara me elemente provuese të gfarëdo natyre tjetër, të përcjella prej DSJK-së në raportin e saj, nuk janë të tilla që të bindin trupin gjykues se subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*
12. Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi në Kolegji, ka rezultuar e provuar se Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.04.1999, ka dërguar për gjykim në Gjykatën e

Rrethit Tiranë *dosjen penale nr. {***} në ngarkim të të pandehurve V. A., Dh. G., A. A., E. B. dhe A. M.*, të akuzuar për veprën penale të vjedhjes me anë të mashtrimit të kryer në bashkëpunim dhe kryerje të krimeve nga organizata kriminale, vepër kjo që parashikohet nga neni 143-25 (68857 herë) – 334/1 të Kodit Penal.

13. Kryesues i trupit gjykues për shqyrtimin e kësaj çështjeje penale caktohet gjyqtar Fehmi Petku. Pas shpalljes së trupit gjykues, prokurori i çështjes ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit Fehmi Petku, për arsye se vazhdimi i gjykimit nga ana e tij përbënte shkelje të nenit 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, pasi kishte interes në këtë procedim penal.
14. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, të datës 30.07.1999, vendos pranimin e kërkesës të bërë nga organi i prokurorisë, duke përjashtuar Fehmi Petkun nga gjykimi i çështjes penale me nr. {***} akti, datë 27.04.1999, në ngarkim të të pandehurve V. A., etj.
15. Kundër vendimit të Apelit ka depozituar rekurs më datë 02.08.1999, V. A., duke e konsideruar këtë vendim në kundërshtim flagrant me ligjin, presion të hapur që ushtron organi i akuzës ndaj gjyqtarëve për të mbuluar shkeljet e rënda që ka lejuar gjatë hetimit në dëm të interesave të tij dhe në bazë të nenit 22/4 të K.Pr.P, ka kërkuar prishjen e vendimit nga Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë me vendimin nr. {***}, datë 24.08.1999, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur dhe lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 30.07.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë”.
16. Nga shqyrtimi i çështjes, ka rezultuar e provuar se i pandehuri V. A. ka qenë palë e disa marrëdhënieve juridike mes tij dhe babait të subjektit të rivlerësimit, z. A. P., konkretisht në cilësinë e blerësit të pasurisë banesë, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë dhe në cilësinë e huamarrësit me huadhënës A. P. Me kalimin e shoqërisë “{***}” ShPK në *shoqëri në administrim*, babai i subjektit të rivlerësimit A. P. ka qenë palë e një procesi të gjatë gjyqësor civil me administratorët e kësaj shoqërie, me objekt njohjen e A. P. si pronar i vetëm i banesës në rr. “{***}”, Tiranë, të ardhurat nga shitja e së cilës kanë shërbyer si burim për krijimin e gjithë pasurive të tjera të paluajtshme, të blera në vitin 1996, objekte shqyrtimi në procesin e rivlerësimit.
17. Nga analizimi i dokumenteve të administruara, ka rezultuar e provuar se subjekti i rivlerësimit jo vetëm që nuk e ka parë të arsyeshme të kërkojë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes gjyqësore penale me të pandehur shtetasin V. A., por e ka konsideruar kërkesën e prokurorit për përjashtim e tij të pabazuar në ligj.
18. Ndryshe nga arsyetimi më sipër i shumicës së trupit gjykues, mendoj se mosheqja dorë nga gjykimi i çështjes penale nga subjekti i rivlerësimit Fehmi Petku, me të pandehur V.A., përbën konflikt të hapur interesi përgjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar.
19. Bazuar në sa më sipër, me arsyetim ndryshe nga ai që ka përdorur shumica e trupit gjykues, çmoj se ndodhemi në kushtet e rastit klasik të konfliktit të interesit, që cenon drejtpërdrejt *besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016*.
20. Në raportin e kontrollit të figurës, të hartuar nga Grupi i Punës, përcjellë nga DSIK-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2018, disponohen të dhëna për dyshime mbi përfshirjen e

subjektit të rivlerësimit në korrupsion pasiv gjatë gjykimit të disa çështjeve gjyqësore, dhe në përfundim ka vlerësuar *papërshtatshmëri të subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës*.

21. Nisur nga fakti që autoritetet përgjegjëse për kontrollin e figurës, sipas ligjit nr. 84/2016, nga informacionet e disponueshme prej tyre, kanë dalë në konkluzionin për *papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës* nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës, analizuar më sipër, referuar qëndrimin të njëjtë të mbajtur nga ana ime në çështje të mëparshme të shqyrtuara në Kolegj, në vlerësimin tërësor të çështjes, mendoj se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë përgjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi